



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 343 Akti

Nr. 396 Vendimi
Tiranë, më 9.6.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datat 2.6.2021 dhe 7.6.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Tomorr Kullolli**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, komisioner Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Tomorr Kullolli,

i cili në seancën dëgjimore publike të datës 7.6.2021, kërkoi riçeljen e hetimit administrativ për kontrollin e figurës dhe për vlerësimin e aftësive profesionale,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

Z. Tomorr Kullolli, për shkak të funksionit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.

Pas hedhjes së shortit të datës 12.11.2019, trupi gjykues nr. 2 – i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Lulzim Hamitaj dhe Xhensila Pine – pasi administroi dhe shqyrtoi raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31 - 44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 19.11.2019, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) me mirëkuptim, të caktohet kryesuesi i trupit gjykues, komisionere Valbona Sanxhaktari. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.

Në vijim të hapave hetimore, në datën 25.2.2021, me vendimin nr. 2, trupi gjykues, pasi vlerësoi ekzistencën e një niveli të lartë provueshmërie të provave të administruara, vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe, në bazë të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, çmoi që procesi i rivlerësimit për z. Tomorr Kullolli të bazohej vetëm në kriterin e pasurisë.

Në datën 25.2.2021 Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova të mundshme për të provuar të kundërtën, brenda datës 16.3.2021; (iii) të njihet me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

Pavarësisht njoftimit të rregullt në rrugë elektronike, si më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit pranë Komisionit për t'u njohur me dosjen dhe as nuk paraqiti shpjegimet dhe parashtrimet e tij brenda afatit që i ishte përcaktuar.

Në datën 2.3.2021 subjekti ka paraqitur në KLGJ një kërkesë të përvokueshme për heqje dorë nga statusi i magjistratit – të cilën e ka depozituar të njëjtën ditë edhe pranë protokollit të Komisionit. Në këto kushte, trupi gjykues, me vendimin e ndërmjetëm nr. 3, të datës 5.3.2021, ka vendosur që të kryejë verifikime të mëtejshme lidhur me vendimmarrjen e KLGJ-së, duke mos e caktuar datën për seancë dëgjimore për këtë subjekt menjëherë pas mbarimit të afatit për paraqitjen e përgjigjeve/prapësimeve të tij.

¹ Paragrafi 3 i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikojnë se: "Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit *ex officio*".

Më pas, ka rezultuar se në datën 23.3.2021, subjekti i rivlerësimit, në mënyrë kontradiktore, ka hequr dorë nga kërkesa në fjalë – ndonëse ajo ishte e parevokueshme – dhe pa i bërë me dije Komisionit lidhur me këtë veprim të tij.

Ndonëse Komisioni kishte kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion pranë KLGJ-së, vetëm në datën 14 maj është përcjellë pranë tij vendimi nr. ***, datë 8.4.2021, i KLGJ-së – me të cilin ishte përfunduar procedura e shqyrtimit të kërkesës së subjektit, pikërisht për shkak të heqjes dorë prej tij nga kjo kërkesë.

Në këto kushte, menjëherë pas marrjes dijeni të kësaj dinamike, trupi gjykues, në zbatim të vendimit të ndërmjetëm nr. 4, datë 14.5.2021, e ka rifituar subjektin për të paraqitur qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit – të njoftuara në datën 25 shkurt – duke i ricaktuar një tjetër afat, deri në datën 20.5.2021. Edhe pas këtij njoftimi subjekti nuk i ka paraqitur prapësimet e tij, por me *e-mail*-in e datës 18.5.2021, është shprehur se më 23.3.2021 kishte paraqitur një tjetër kërkesë në KLGJ (e cila nuk i ishte bërë me dije Komisionit – sikurse heqja dorë nga kërkesa e mëparshme, e datës 2 mars). Këtë herë kërkesa e subjektit ishte paraqitur për miratimin e pensionit të parakohshëm nga KLGJ-ja.

Në vijim, Komisioni, nëpërmjet *e-mail*-it të datës 19.5.2021, i ka bërë me dije subjektit se fakti i paraqitjes së kësaj kërkesë në KLGJ nuk kishte asnjë efekt pezullues për procesin e tij të rivlerësimit nga Komisioni, duke e ftuar sërish që të paraqiste qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit, nëse do ta vlerësonte të dobishme për mbrojtjen e tij.

Në datën 20 maj, ditë në të cilën përfundonte edhe afati i ricaktuar për paraqitjen e qëndrimit të subjektit ndaj rezultateve të hetimit kryesisht, ky i fundit sërish nuk i ka depozituar prapësimet e tij, por i ka nisur Komisionit një tjetër *e-mail*, nëpërmjet të cilit argumentonte dhe insistonte se, sipas tij, Komisioni nuk duhej të vijonte procesin e rivlerësimit, por *duhet të presë vendimmarrjen e KLGJ-së*, lidhur me kërkesën e tij për pension të parakohshëm.

Në vijim, në mungesë të komunikimeve të mëtejshme nga subjekti apo nga KLGJ-ja – në zbatim të vendimit të ndërmjetëm nr. 5, datë 24.5.2021 – Komisioni, me *e-mail*-in, datë 24.5.2021, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit për caktimin e seancës dëgjimore, në datën 2 qershor.

II. SEANCA DËGJIMORE

Në seancën e datës 2.6.2021, subjekti u paraqit personalisht dhe pohoi se nuk e kishte përgatitur mbrojtjen e tij, pasi ishte i bindur se kërkesa e paraqitur pranë KLGJ-së do të pranohej dhe i kërkoi në mënyrë verbale trupit gjykues për t'i dhënë më shumë kohë, për t'i mundësuar caktimin e një avokati, si dhe për përgatitjen e mbrojtjes së tij. Gjithashtu, subjekti paraqiti një kërkesë me shkrim, nëpërmjet të cilës kërkonte mosvijimin e procesit të rivlerësimit, në pritje të vendimit të KLGJ-së, mbi kërkesën e paraqitur prej tij për pension të parakohshëm.

Trupi gjykues, pasi u tërhoq në dhomë këshillimi dhe shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga subjekti verbalisht në seancë, për të pasur një kohë shtesë në dispozicion për mbrojtjen e tij, ndonëse e konsideroi të pabazuar në fakte – për sa kohë ai vetë kishte zgjedhur të mos e përgatiste mbrojtjen e tij (prej datës 25 shkurt që i ishin bërë me dije nga Komisioni, rezultatet e hetimit administrativ), pa pasur ndonjë shkak pengues/justifikues për këtë mosveprim – në frymën e realizimit të një procesi të rregullt ligjor, me vendimin e ndërmjetëm nr. 6, datë 2.6.2021,

vendosi që pas relatimit të rezultateve të hetimit të shtyjë seancën dëgjimore, duke i dhënë sërish subjektit kohë shtesë për mbrojtjen e tij, deri në datën 7.6.2021.

Gjithashtu, me të njëjtin vendim të ndërmjetëm (nr. 6), trupi gjykues vendosi të mos e pranojë kërkesën e subjektit, të paraqitur me shkrim në seancë, për mosvijimin e procesit të rivlerësimit derisa KLGJ-ja të shprehej mbi kërkesën e tij – pasi ishte e përsëritur (shkaqet e mospranimit të së njëjtës kërkesë më të hershme ishin të përshkruara në *e-mail*-in e datës 19.5.2021, që Komisioni i kishte nisur subjektit) dhe e pa bazuar në fakte dhe në ligj, për sa kohë kërkesa e paraqitur pranë KLGJ-së nuk interferonte procesin e rivlerësimit dhe mund të mos pranohej nga ky institucion për mosplotësimin e kriterëve të parashikuara për pension të parakohshëm – siç rezultoi më pas.

Subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij ligjor u paraqitën në seancën e datës 7.6.2021, të cilët shprehën qëndrimin e tyre, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer nga Komisioni. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, iu përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe shprehu qëndrimin e tij përfundimtar, duke kërkuar riçeljen e hetimit administrativ edhe për kontrollin e figurës, edhe për vlerësimin e aftësive profesionale.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, duke mos e konsideruar të provuar të kundërtën e rezultateve që i ishin kaluar barrë prove subjektit, vendosi të konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin Tomorr Kullolli, duke u bazuar vetëm mbi kriterin e rivlerësimit të pasurisë.

Seanca dëgjimore e datës 7.6.2021, u mbyll, për të rifilluar më 9.6.2021, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Tomorr Kullolli ka mbajtur një qëndrim pjesërisht bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje jo të plota dhe nuk ka paraqitur në afatet e caktuara as shpjegime/prapësime në raport edhe mbi rezultatet e hetimit dhe as dokumentacion ligjor mbështetës në lidhje me burimet financiare të pasurive të tij, siç i është kërkuar nga Komisioni në mënyrë të përsëritur.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- i. provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*;
- ii. raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- iii. provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- iv. deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;

- v. shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, si dhe argumentimeve të bëra verbalisht nga subjekti në seancën dëgjimore të datës 7.6.2021;
- vi. deklaratimet e personave të lidhur, apo të tjerë të lidhur;
- vii. faktet e njohura botërisht.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

ILDKPKI-ja, bazuar në nenet 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Tomorr Kullolli, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesave.*

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mundësisë së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; si dhe evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, parashikuar në pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

1. Apartament me sipërfaqe 67.4 m², në lagjen “K. E.”, Elbasan

1. Kjo pasuri është deklaruar fillimisht nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2004, në të cilën ka deklaruar blerjen e apartamentit në fjalë nga bashkëshortja e tij, por nuk ka deklaruar burimin e krijimit. Në dokumentacionin fizik të dosjes së ILDKPKI-së lidhur me të dhënat e DIPP-së së vitit 2004, rezulton të jetë plotësuar² në datën 11.1.2007 informacion mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, me të ardhurat e përfituara si vijon:
 - a. dividendët nga shoqëria “***” sh.a., në shumën 1,721,348 lekë³, paguar sipas mandatpagesës në datën 18.10.2000; dhe
 - b. të ardhura të tjera pas vitit 2000.
2. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim krijimi të kësaj pasurie, të ardhurat familjare.

² Në dosjen fizike të ILDKPKI-së rezulton të jetë vendosur shënimi shtesë/plotësues në DIPP-në e vitit 2004, pas përshkrimit të pasurisë në fjalë, të ardhurat e përdonura. Në fund të kësaj faqeje rezulton të jetë firmosur nga subjekti i rivlerësimit dhe të jetë shënuar data 11.1.2007.

³ Sipas vërtetimit nr. *** prot., datë 25.1.2017, të lëshuar nga shoqëria “***” sh.a., subjekti i rivlerësimit ka marrë në vitin 2000 të ardhura në vlerën 1,721,348 lekë.

3. Pasuria në fjalë është përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 24.9.2004⁴, në të cilën pala shitëse A. dhe A. S. i kanë shitur bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit apartamentin me sip. 68 m², me nr. pasurie ***, të ndodhur në z. k. ***, kundrejt çmimit total prej 1,950,000 lekësh.
4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar janë evidentuar mospërputhje në numrin e pasurisë dhe në sipërfaqen e këtij apartamenti, midis dokumentacionit të pronësisë dhe përshkrimit të pasurisë në kontratën e shitblerjes. Po ashtu, ka rezultuar një mospërputhje midis çmimit të deklaruar në DIPP-në 2004 krahasuar me kontratën e shitblerjes. Në këto kushte, Komisioni, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, i ka kërkuar subjektit të sqarojë nëse kemi të bëjmë me të njëjtin apartament. Në përgjigje të tij, subjekti i rivlerësimit është shprehur se numri i pasurisë dhe sipërfaqja në kontratën e shitblerjes kanë qenë lapsuse të pakonstatuara nga palët, ndërsa çmimi i shitblerjes i deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, ka qenë një pasaktësi nga ana e tij. Gjithashtu, subjekti ka konfirmuar se bëhet fjalë për të njëjtin apartament dhe se pagesa është kryer në *cash*.
5. Bazuar në udhëzimin nr. 1, datë 4.3.2004, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit 'K'", ka rezultuar se vlera mesatare e shitjes së apartamenteve në tregun e lirë në vitin 2004, për qytetin e Elbasanit, ka qenë 44,611 lekë/m², në bazë të të cilit, për këtë apartament, do të rezultonte çmimi prej 3,006,781 lekësh.
6. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 3, të shpjegojë mbi arsyet e blerjes së kësaj pasurie, rreth 35 % nën mesataren e çmimit të tregut të periudhës në fjalë, duke bërë gjithashtu me dije mbi marrëdhënie të mundshme familjare, shoqërore apo të çfarëdolloji. Në përgjigje të pyetësorit, subjekti është shprehur se për këtë vlerë kanë rënë dakord me palën shitëse dhe se nuk ka pasur asnjë lloj marrëdhënieje familjare ose shoqërore me ta, por nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar sa më sipër.
7. Duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2008, subjekti ka deklaruar çdo vit⁵ të ardhura nga dhënia me qira e këtij apartamenti të ndodhur në lagjen "K. E.", të kthyer në ambient shërbimi, në masën 600,000 lekë/vit, përveçse për vitin 2016, për të cilin janë deklaruar në shumën 500,000 lekë. Ndërkohë, në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura në total në shumën 4,800,000 lekë nga qiradhënia e këtij apartamenti.
8. Nga përmbajtja e kontratave të qirasë të paraqitura nga subjekti⁶, për aq sa disponohet nga Komisioni, janë përlogaritur të ardhura në shumën totale prej 990,000 lekësh.
9. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pasi i është kërkuar të japë shpjegime mbi sa më sipër, subjekti ka bërë me dije se apartamenti është kthyer në tri njësi shërbimi, të cilat janë dhënë me qira ndër vite, me kontrata deri në një vit. Ai ka shtuar se në shumicën e rasteve

⁴ Në DIPP-në e vitit 2004, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar datën e krijimit të pasurisë, 29.4.2005. Më parë, në DIPP-në e vitit 2003 ka deklaruar si adresë banimi shtëpinë e babait, banesën private në lagjen "S.", Elbasan.

⁵ Me përjashtim të DIPP-së së vitit 2014, në të cilin subjekti nuk ka deklaruar të ardhura nga qiradhënia, por ka deklaruar të ardhura në shumën 1,200,000 lekë për vitet 2014 dhe 2015, në DIPP-në e vitit 2015.

⁶ Bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, subjekti ka paraqitur vetëm tri kontrata qiraje, përkatësisht kontratën nr. *** kol., të lidhur në datën 17.10.2011, me qiramarrës A. R., kundrejt qirasë 15,000 lekë/muaj, për një dhomë në apartamentin me sip. 67.4 m²; kontratën nr. *** prot., datë 25.11.2013, të lidhur me qiramarrësin H. P., kundrejt qirasë 15,000 lekë/muaj, për një ambient me sip. 25 m² të pasurisë në fjalë; kontratë nr. *** regi., datë 13.1.2009, të lidhur me qiramarrësin K. B., kundrejt qirasë 20,000 lekë/muaj.

nuk janë lidhur kontrata me shkrim, si dhe disa kontrata nuk janë ruajtur. Lidhur me dokumentacionin ligjor që i është kërkuar për të vërtetuar ndryshimin e destinacionit të pasurisë në fjalë nga apartament në njësi shërbimi, subjekti është shprehur se nuk ka bërë regjistrim të këtij ndryshimi dhe nuk ka paraqitur dokumentacion. Për sa i përket shpenzimeve të punimeve të nevojshme për ndryshimin e destinacionit nga një apartament në tri njësi shërbimi, subjekti është shprehur se nuk ka bërë ndonjë shpenzim të mirëfilltë dhe se vlera e tyre nuk e kalon shumën e kërkuar për deklaram në vitin përkatës, duke mos dhënë ndonjë vlerë konkrete.

10. DPT-ja dhe DRT-ja Elbasan, pas kërkesës së dërguar nga Komisioni, me anë të shkresave nr. *** prot., datë 7.2.2020, dhe nr. *** prot., datë 10.2.2020, kanë konfirmuar se subjekti i rivlerësimit figuron i regjistruar si individ privat në datën 30.4.2018, momenti kur rezulton të ketë dorëzuar DIVA-n e vitit 2017⁷ dhe nuk ka rezultuar ndonjë pagesë për tatimin mbi të ardhurat nga qiradhënia.
11. Për këtë arsye, Komisioni iu drejtua subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, duke i kërkuar të paraqesë dokumentacionin që të provojë kryerjen e pagesave të detyrimeve përkatëse tatimore për të ardhurat e përfituara nga qiradhënia, në përgjigje të të cilëve ka pohuar se ka paguar për disa vite dhe se për momentin nuk mund të japë dokumentacion lidhur me sa detyrime tatimore ka paguar ndër vite, pasi ky informacion nuk i është vënë në dispozicion nga institucioni përkatës.
12. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:
 - i. ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, ka konfirmuar pasurinë e llojit “apartament”, me sip. 67.4 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***, të ndodhur në lagjen Kongresi i Elbasanit, në pronësi të shtetases L. K.;
 - ii. kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 24.9.2004, të lidhur ndërmjet palës shitëse A. dhe A. S. dhe palës blerëse L. K., për blerjen e pasurisë në fjalë, kundrejt çmimit 1,950,000 lekë;
 - iii. vërtetim nr. *** prot., datë 25.1.2017, lëshuar nga shoqëria “****” sh.a., nga ku ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka qenë aksioner në këtë shoqëri nga viti 1996 dhe ka përfituar të ardhura në total 3,425,690 lekë deri në vitin 2014.

1.1. Analizimi i burimeve të krijimit për blerjen e kësaj pasurie

13. Lidhur me burimet e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit në plotësimin e bërë në datën 11.1.2007, të DIPP-së së vitit 2004, konstatohet se përfshijnë të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga shoqëria aksionare “****” sh.a., të përfituara në vitin 2000, si dhe të ardhura të tjera pas vitit 2000. Bazuar në vërtetimin e kësaj shoqërie rezulton se për vitin 2000 subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura në masën 1,721,348 lekë⁸.
14. Ndërkohë, nga shqyrtimi i DIPP-së së vitit 2003, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar ndonjë gjendje të disponuar *cash* në banesë apo likuiditete

⁷ Për këtë vit, subjekti rezulton të ketë deklaruar të ardhurat nga paga, si dhe të ardhura nga qiradhënia në shumën 200,000 lekë dhe të ardhura të tjera në shumën 1,200,000 lekë, për të cilat i ka rezultuar një detyrim tatimor për t’u paguar në shumën 210,000 lekë.

⁸ Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar mandatpagesën e datës 18.10.2000, të përmendur në plotësimin e DIPP-së së vitit 2004, për përfitimin e shumës 1,721,348 lekë nga shpërndarja e dividendit nga shoqëria “****” sh.a.

të tjera, kursime që mund të kishin shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2004.

15. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, nëpërmjet të cilit subjekti është ftuar të japë shpjegime mbi sa më sipër, ka bërë me dije se nuk i kujtohet, por fakti që këto të ardhura janë siguruar nga shpërndarja e dividendëve është i vërtetë, pasi ato janë pasqyruar në mandatkanimet e bankës, të cilat i ka deklaruar si në deklaratën *Vetting*, ashtu edhe në ato periode vjetore. Subjekti nuk ka vënë në dispozicion mandatet e pagesës/transferimit të cituara prej tij dhe nuk ka dhënë ndonjë shpjegim për mosdeklarimin e gjendjes *cash* së disponuar në banesë. Gjithashtu, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni nuk ka rezultuar ndonjë veprim bankar apo llogari e subjektit e disponuar përpara vitit 2005.
16. Për rrjedhojë, Komisioni ka analizuar mundësinë e kursimit të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortes së tij, duke filluar nga janari i vitit 2004 dhe deri në datën e kryerjes së transaksionit më 24.9.2004.
17. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka filluar punë në datën 25.10.2004⁹, pra, pas blerjes së pasurisë në fjalë. Ndërsa, subjekti i rivlerësimit ka përfutur për vitin 2004 të ardhura në masën 878,720 lekë¹⁰.
18. Pas përllogaritjes së shpenzimeve jetike të familjes së subjektit për një periudhë 9-mujore gjatë vitit 2004, ka rezultuar se subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e pasurisë në analizë, në masën -1,572,552 lekë, siç është detajuar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 1 – Analiza e burimeve të përdorura për blerjen e pasurisë

Të ardhura janar - shtator 2004	659 040
Blerë apartament në Elbasan	(1 950 000)
Shpenzime janar - shtator 2004	(281 592)
Rezultati	(1 572 552)

19. Nisura nga sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me rezultatet, si vijon:
 - *Duket se ka mospërputhje midis të ardhurave nga qiraja: (i) të deklaruara ndër vite, krahasuar me të ardhurat në total; (ii) të deklaruara në deklaratën *Vetting*; dhe (iii) atyre të provuara nëpërmjet kontratave të qirave.*
 - *Duket se të gjitha shumat e pretenduara si të përfituara nga qiradhënia e apartamentit në analizë për periudhën 2008 – 2016 nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për sa kohë për to nuk janë paguar detyrimet tatimore.*
 - *Duket se për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2004 subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, në masën 1,572,552 lekë.*

⁹ Bazuar në vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* nga ISSH-ja, punëdhënësi DAR Elbasan.

¹⁰ Bazuar në vërtetimin e datës 12.1.2017, të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

20. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar rezultatin e arritur nga Komisioni, duke pretenduar se për krijimin e kësaj pasurie ka pasur kursime në gjendje *cash* nga të ardhurat e përfituara nga dividendët e shpërndara nga shoqëria “****”, sh.a., Elbasan, në vitin 2000, prej 1,721,384 lekësh dhe të përdorura për blerjen në vitin 2004. Po ashtu, subjekti është shprehur se mosdeklarimi prej tij i gjendjeve *cash* të disponuara në fund të viteve përkatëse ka ndodhur për shkakun se nuk ka pasur trajnime sqaruese nga ILDKPKI-ja lidhur me plotësimin e deklaratave periodike dhe, për rrjedhojë, ka pasaktësi në deklaratimet e tij. Subjekti ka shtuar gjithashtu se plotësimi i kryer prej tij në vitin 2007, duke shtuar si burim të ardhurat nga dividendët e vitit 2000, tregon një vullnet të pavesuar.
21. Lidhur me të ardhurat e përfituara nga zotërimi i kuotave të dy shoqërive, subjekti ka shpjeguar se është bërë pronar duke blerë këto aksione në vitin 1995 me ankand të mbyllur, pasi të paralindurit e tij kanë përfituar shpërblime me letra me vlerë, të cilat mund të përdoshin në procesin e privatizimit. Babai i subjektit kishte përfituar nga ky dëmshpërblim, ashtu sikurse edhe gjyshi, i cili kishte ndërruar jetë në vitin 1989. Ndërkohë, subjekti ka sqaruar se ka përfituar letra me vlerë edhe nga xhaxhai i tij D. dhe nga R. K., të cilët nuk kishin fëmijë dhe pas vdekjes ka qenë trashëgimtar i tyre. Në vitin 1995 babai i subjektit dispononte letrat me vlerë të tij dhe të gjyshit dhe ia ka kaluar që t’i përdorte për privatizimin. Subjekti i rivlerësimit ka pohuar se nuk disponon dokumentacion lidhur me sasinë, mënyrën e kohën e përfitimit të këtyre letrave me vlerë, pasi ka kaluar një kohë e gjatë dhe as bankat nuk i disponojnë. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar, në cilësinë e provës, një urdhër-xhirim të datës 20.12.1995, sipas së cilës shtetasja R. K. i ka kaluar letrat me vlerë privatizimi shtetasit Tomorr Kullolli, në shumën 901,153 lekë.
22. Ndërsa, për sa i takon pagesës së tatimeve mbi shumat e përfituara nga subjekti si dividendin këtyre shoqërive ndër vite, ai ka shpjeguar se tatimet janë paguar nga shoqëritë që kanë ndarë dividendin – por pa paraqitur prova apo argumentim mbi bazën ligjore apo kontraktore se përse shoqëritë do të duhej të paguanin tatimin mbi fitimin e një aksioneri. Gjithashtu, subjekti pretendoi se të ardhurat e realizuar nga shitja e aksioneve duhet të njihen si të ardhura të ligjshme, së paku për sa i takon diferencës midis çmimit të blerjes dhe asaj të shitjes së tyre.
23. Lidhur me të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pasurive të paluajtshme, subjekti është shprehur se kontratat e qirasë kanë qenë me afat 1-vjeçar dhe sipas Kodit Civil nuk ka pasur nevojë që të bëheshin me shkresë. Subjekti ka shtuar se mesa i kujtohet ka paguar tatimin mbi këto të ardhura, por nuk disponon dokumentacion.

Vlerësimi i trupit gjykues

24. Lidhur me pretendimin e subjektit për përdorimin e kursimeve të mëhershme, trupi gjykues vëren se, ndonëse subjekti ka përfituar të ardhura në vitin 2000 nga shpërndarja e dividendëve, ai nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2003 kursime të disponuara *cash* në banesë. Gjithashtu, në deklaratimin “plotësues” të kryer në vitin 2007, subjekti ka shtuar si burim të ardhurat nga dividendët e përfituar në vitin 2000, por nuk ka përcaktuar ndonjë shifër/shumë konkrete të kursyer prej tij deri në vitin 2004. Për më tepër që nuk ka

rezultuar e provuar sasia valutore e letrave me vlerë që subjekti ka pretenduar si të poseduara – me prejardhje të ndryshme (nga gjyshi, babai dhe xhaxhai i tij) – dhe as mënyra, koha e ligjshmëria e përfitimit të tyre, që, sipas subjektit, kanë përbërë burimin e ligjshëm të blerjes/përfitimit të aksioneve të shoqërive aksionare në vitin 1995, nga të cilat janë gjeneruar këto dividendë.

25. Gjithashtu, lidhur me ligjshmërinë e shumave të përdorura në vitin 2004, trupi gjykues vlerëson të vërë në pah faktin që, edhe nëse do të konsiderohej i mirëqenë burimi i ligjshëm i blerjes së aksioneve në fjalë, sërish do të gjendeshim përballë mungesës së provës mbi zotërimin faktik dhe mbi ligjshmërinë e burimeve financiare të përfituara nga dividendët e shoqërive aksionare të lartpërmendura, pasi nuk është deklaruar kursimi në gjendje *cash* dhe as nuk është provuar pagesa e tatimit mbi shumat e përfituara nga dividendët. Pretendimi i subjektit se këto tatime janë paguar nga vetë shoqëritë që kanë gjeneruar dividend nuk rezulton të jetë i provuar. Për rrjedhojë, edhe në rast se do të pranohej pretendimi i subjektit mbi disponimin e këtyre kursimeve nga viti 2000 deri në vitin 2004, duke e konsideruar mosdeklarimin e gjendjes *cash* vetëm si një pasaktësi – çka do të binte ndesh me dispozitat ligjore dhe jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit – këto të ardhura gjithsesi nuk mund të konsideroheshin me burim krijimi të ligjshëm, për sa kohë nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore mbi këto shuma të përfituara nga subjekti nëpërmjet aksioneve të tij. Nisur nga sa më lart, konfirmohet mungesa financiare për vitin 2004, në vlerën negative prej 1,572,552 lekësh.
26. Së fundmi lidhur me këto burime të ardhurash, evidentohet se arsyetimi i mësipërm – mbi pengesën/mungesën e trefishtë, të kushteve të paplotësuara, për konsiderimin e tyre si burime të ligjshme – vlen dhe duhet të mbahet në konsideratë edhe përgjatë analizave financiare të viteve të mëpasme, për aq kohë sa rigjendemi në rrethana të ngjashme, pra, përballë shpenzimeve të subjektit, të kryera me të ardhura nga dividendët, për të cilat, edhe kur janë deklaruar si të ardhura në vitet përkatëse, nuk rezultojnë të jenë shlyer detyrimet tatimore.
27. Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat e realizuara nga shitja e një pjese të aksioneve të shoqërive së sipërcituara, trupi gjykues çmon se duhet konsideruar në analizën financiare vetëm pjesa e çmimit të përfituar ekuivalent me çmimin e blerjes, duke mos e konsideruar si një burim të ligjshëm diferencën midis dy çmimeve, për sa kohë nuk është provuar pagesa e blerjes së këtyre aksioneve me burime të ligjshme financiare. Sikurse është trajtuar edhe më lart, tek analiza e problematikave të burimit të pretenduar si letra me vlerë, subjekti ka dështuar të provojë sasinë dhe mënyrën formale/ligjore të përfitimit të tyre, pasi ato mbetën të paprovuara, si në aspektin sasior, ashtu edhe lidhur me kalimin dhe legjitimitetin e zotërimit të tyre në favor të subjektit. Për rrjedhojë, nuk mund të legjitimohet as përdorimi i shumave të përfituara nga shitja e aksioneve, për sa kohë nuk është provuar burimi i ligjshëm që ka mundësuar blerjen e këtyre aksioneve. Gjithsesi, edhe nëse do të konsiderohej në analizë financiare kjo e ardhur, sipas pretendimeve të subjektit, kjo nuk do të ndryshonte konkluzionin final, pasi sërish do të gjendeshim përballë një pamundësie financiare të konsiderueshme.

2. Shtëpi private dykatëshe, ndodhur në rrugën “R. Ç.”, lagja “Q. S.”, Elbasan

28. Kjo pasuri e llojit “ndërtesë” me sip. 89 m² dhe truall me sip. 255 m² është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2006¹¹, pa e deklaruar burimin financiar të krijimit në rubrikën përkatëse, por në seksionin e detyrimeve financiare dhe të të dhënave që nuk publikohen, subjekti ka deklaruar disa huamarrje për blerjen e banesës në fjalë dhe, konkretisht, në vlerat dhe nga shtetasit e poshtë përshkruar:
- A. A. – në vlerën 2,000,000 lekë;
 - S. M. – në vlerën 2,000,000 lekë;
 - A. Xh. – në vlerën 1,000,000 lekë;
 - P. Xh. – në vlerën 1,000,000 lekë;
 - A. K. – në vlerën 5,000 euro.
29. Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e krijimit të kësaj pasurie nga huaja dhe kredi të shlyera ndër vite. Kjo pasuri¹² rezulton të jetë e përbërë nga dy apartamente me sip. 88.75 m² secila, të ndodhura në katin e parë dhe të dytë të ndërtesës, si dhe tri troje me sipërfaqe, përkatësisht 66.6 m², 100.52 m² dhe 88.75 m².
30. Në DIPP-në e vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerjen pjesërisht të huave në shumën 3,104,550 lekë, përkatësisht nga 1,000,000 lekë shtetasve A. A. dhe P. Xh., 500,000 lekë shtetasit A. Xh. dhe 5,000 euro ndaj shtetasit A. K., si dhe marrjen e kredisë në shumën 2,500,000 lekë në “Raiffeisen Bank” me objekt “për blerje shtëpie”. Bashkëlidhur dokumentacionit të kredisë së ardhur nga banka ndodhet një deklaratë noteriale¹³ nga njëri prej huadhënësve S. M., i cili ka deklaruar se i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën 2,500,000 lekë për blerjen e shtëpisë, shumë e cila do t’i kthehej me anë të kredisë bankare.
31. Lidhur me mospërputhjen e konstatuar nga Komisioni midis shumës së huas në deklarimin e subjektit në DIPP dhe asaj të përshkruar në deklaratën noteriale të sipërcituar, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, është shprehur se shuma prej 2,000,000 lekësh është marrë hua në vitin 2006, ndërsa shuma shtesë prej 500,000 lekësh është marrë në vitin 2007 dhe është shlyer totalisht me kredinë e marrë në të njëjtin vit. Ndërkohë, nga shqyrtimi i deklarimit në plotësim të DIPP-së së vitit 2007, subjekti ka deklaruar shlyerjen e huas ndaj shtetasve të tjerë dhe detyrimin e shtetasit S. M. si të palikuiduar.
32. Gjithashtu, nga shqyrtimi i deklaratave periodike të subjektit është konstatuar se ky i fundit ka deklaruar shlyerje të këtyre detyrimeve deri në DIPP-në e vitit 2011¹⁴, në

¹¹ Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti ka deklaruar si adresë banimi shtëpinë/banesë private në lagjen “Q. S.”, Elbasan, që përputhet me adresën e pasurisë në fjalë.

¹² ILDKPKI-ja, me cilësinë e kallëzuesit, ka depozituar kallëzimin penal me objekt “refuzim për deklarim, mosdeklarim, fshehje ose deklarim i rremë”, pasi ka ushtruar kontrollin e plotë të deklaratës, pasi sipas tyre: në DIPP-në e vitit 2006 ka fshehje të pasurisë dhe mungesë të burimeve financiare, pasi subjekti ka deklaruar një shtëpi banimi me sip. 89 m² dhe truall me sip. 225 m², ndërsa nga verifikimi shtëpia është me dy kate, me sip. 88.75 m² secili kat dhe truall është me sip. 260.87m²; nuk ka deklaruar shtim të llogarisë së pagës; në DIPP-në e viteve 2007, 2008 dhe 2013 ka deklaruar aksione, por rezultoi të jetë në kushtet e konflikti të interesit, për shkak të funksionit gjyqtar; në vitin 2012 ka deklaruar dhuratë nga babai vlerën prej 9,300,000 lekësh, me burime jo të ligjshme financiare, pasi ky i fundit ka qenë pensionist dhe nuk ka pasur mundësi kursimi të kësaj shume. Në përfundim të sa më sipër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: “Pushimin e procedimit penal nr. *** të vitit 2015”. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më vendimin nr. *** regj. themeltar, datë 11.2.2016, ka vendosur: “Pranimin e kërkesës penale nr. *** regj., them., që i përket ankuesit T. Kullolli, ndryshimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 26.10.2015”, vendim i cili nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë më 21.2.2016.

¹³ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.5.2007.

¹⁴ Në DIPP-në e vitit 2010, për shkak të funksionit të saj si përmbareuese, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka deklaruar huamarrjen në vlerën 1,500,000 lekë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka shpjeguar se bashkëshortja duhet të ketë deklaruar vlerën e mbetur të huamarrjeve që kanë pasur në atë vit, që përputhet edhe me shumën e mbetur pa shlyer të huave të marra nga subjekti.

shumën totale 5,500,000 lekë dhe 5,000 euro, si dhe nuk ka deklaruar më në vijim shlyerjen e një detyrimi të mbetur prej 500,000 lekësh, i cili nuk është deklaruar as në deklaratën *Vetting* si një detyrim ende ekzistues/i mbartur.

33. Komisioni, nëpërmjet pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 3, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të paraqesë dokumentacionin ligjor që të provonte kohën dhe mënyrën e marrjes (apo dhënies) së shumave të huas, të kthimit pas të tyre si dhe dokumentacionin ligjor që të provonte burimin e ligjshëm të të ardhurave të secilit prej huadhënësve. Subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se me të gjithë huadhënësit ka lidhje farefisnore, ai vetë ose bashkëshortja e tij, dhe për këtë arsye nuk kanë nënshkruar kontrata huaje dhe se në dijeninë e tij, ata kanë pasur burime të ligjshme financiare, pasi një pjesë kanë pasur biznese të regjistruara dhe një pjesë kanë punuar në emigrim. Në këtë mënyrë, subjekti i rivlerësimit, përpos një shpjegimi sipërfaqësor, nuk ka paraqitur dokumentacion që të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, mënyrën dhe kohën e marrjes hua të shumave të pretenduara¹⁵, siç i ishte kërkuar.

34. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

- i. ASHK-ja Elbasan, me shkresën nr. *** prot., datë 27.2.2020, ka konfirmuar se në emër të bashkëshortes së subjektit rezultojnë të regjistruara pesë pasuritë e paluajtshme të ndodhura në z k. ***, me të dhënat si më poshtë, për të cilat ka bashkëlidhur kartelat e pasurive dhe praktikat përkatëse:
 - a. apartament me sip. 88.75 m², me nr. pasurie ***;
 - b. apartament me sip. 88.75 m², me nr. pasurie ***;
 - c. truall me sip. 66.6 m², me nr. pasurie ***;
 - d. truall me sip. 100.52 m², me nr. pasurie ***;
 - e. truall me sip. 88.75 m², me nr. pasurie ***.
- ii. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.9.2006, me palë shitëse Ll. B. dhe V. B. dhe palë blerëse L. K., për blerjen e dy pasurive, përkatësisht trualli me sip. 100.52 m², me nr. *** dhe apartamenti në katin e parë të ndërtesës, me sip. 88.75 m², me nr. ***, kundrejt çmimit total 3,000,000 lekë¹⁶.
- iii. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.9.2006, lidhur ndërmjet palës shitëse Ll. B. dhe R. E. dhe palës blerëse L. K., për pasurinë e llojit “truall”, me sip. 88.75 m², me nr. ***, kundrejt çmimit 1,000,000 lekë.
- iv. Kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 25.9.2006, me palë shitëse R. E. dhe R. Rr. dhe palë blerëse L. K., për blerjen e dy pasurive, përkatësisht trualli me sip. 66.6 m², me nr. *** dhe apartamenti në katin e dytë të ndërtesës, me sip. 88.75 m², me nr. ***, kundrejt çmimit total 2,800,000 lekë¹⁷.

¹⁵ Gjithashtu, subjekti nuk ka vënë në dispozicion dokumentacionin që të konfirmojë marrëdhëniet e deklaruara të huamarrjes, sipas parashikimeve ligjore të përcaktuara në nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, ku: “Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive”.

¹⁶ Vlera 1,000,000 lekë për truallin dhe vlera 2,000,000 lekë për apartamentin.

¹⁷ Vlera 800,000 lekë për truallin dhe vlera 2,000,000 lekë për apartamentin.

- v. "Raiffeisen Bank", me shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2020, ka konfirmuar se subjekti i rivlerësimit ka marrë kredi në datën 15.6.2007, e cila është mbyllur më 15.6.2017, për të cilën ka bashkëlidhur praktikën¹⁸ përkatëse.
- vi. Deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.5.2007, në të cilën subjekti, së bashku me shtetasin S. M., kanë deklaruar se ky i fundit i ka dhënë hua subjektit në shumën 2,500,000 lekë për blerjen e pasurisë, shumë e cila do të shlyhej me kredinë bankare.

2.1 Analizimi i burimeve të krijimit për krijimin e kësaj pasurie

35. Burimi i krijimit të kësaj pasurie, siç u pasqyrua edhe më sipër, në mënyrë indirekte është deklaruar në DIPP-në e vitit 2006 nga huat e marra shtetasve A. A., S. M., A. Xh., P. Xh. dhe A. K.. Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave të huadhënësve, të cilët kanë mundësuar më pas dhënien e këtyre huave në favor të subjektit të rivlerësimit, ky i fundit nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor përkatës për të provuar sa më sipër, as në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe as të atij nr. 3. Për rrjedhojë, këto shuma nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare.
36. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike vjetore të viteve 2003, 2004 dhe 2005 është konstatuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar asnjëherë gjendje *cash*, likuiditete apo kursime të disponuara në banesë, që të mund të ishin përdorur prej tij për blerjen e apartamentit në fjalë.
37. Në këto kushte, nisur nga deklarimi që pagesat në favor të shitësve të pasurive në analizë janë kryer *cash* nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni përlllogaritë të gjitha fondet e tërhequra nga llogaritë bankare të tij dhe të bashkëshortes¹⁹ përgjatë periudhës janar 2006 – 25.9.2006, si një disponibilitet financiar i mundshëm, të cilat rezultuan në masën 420,000 lekë.
38. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve jetike për një periudhë 9-mujore të familjes së subjektit, ka rezultuar se subjekti dhe familja e tij mund të dispononin kursime nga të ardhurat e tyre të vitit 2006, vetëm shumën prej 91,329 lekësh. Rrjedhimisht, për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën -6,708,671 lekë, siç është detajuar në tabelën vijuese.

Tabela nr. 2 – Analiza e burimeve të përdorura për blerjen e pasurive

Fondet e tërhequra janar-25.09.2006	420 000
Blerë banesë private në Elbasan	(6 800 000)
Shpenzime janar - shtator 2006	(328 671)
Rezultati	(6 708 671)

39. Nisur nga sa më sipër lidhur me këtë pasuri, Komisioni i ka kaluar subjektit si barrë prove dy gjetjet e mëposhtme:

¹⁸ Për të garantuar shlyerjen e kësaj kredie, subjekti ka vendosur si garanci hipotekore pasurinë nr. ***, me sip. 88.75 m² dhe pasurinë nr. ***, me sip. 66.6 m².

¹⁹ Bazuar në vërtetimin për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare *neto* nga ISSH-ja, shtetasja L. K., pas shkëputjes në janar të vitit 2005, ka rifilluar punë në mes të muajit shtator të vitit 2006.

- *Duket se ka mospërputhje midis vlerës së huas së deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2006 nga shtetasi S. M., krahasuar me vlerën e huas së përshkruar në deklaratës noteriale të vitit 2007.*
- *Duket se për blerjen e pasurive në fjalë, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme në masën 6,708,671 lekë.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

40. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, është shprehur se ka marrë hua shumën 2,000,000 lekë në vitin 2006 dhe shumën 500,000 lekë në vitin 2007. Për kthimin pas të huas, ka marrë një kredi prej 2,500,000 lekësh, me anë të së cilës dhe të ardhurave nga paga ka kthyer një pjesë të huave deri në fund të vitit 2011. Pas vitit 2011 dhe deri në vitin 2015, pasi nuk i kujtohet koha e saktë, ka shlyer edhe shumën e mbetur prej 500,000 lekësh, por duke qenë se këto pagesa nuk e kalonin shumën 300,000 lekë, nuk i ka deklaruar.
41. Gjithashtu, subjekti, nëpërmjet shpjegimeve të tij të depozituara, sqaron se për blerjen e kësaj banese janë përdorur shumat e marra hua 6,000,000 lekë dhe 5,000 euro. Lidhur me mundësitë financiare të huadhënësve, subjekti ka paraqitur këto shpjegime dhe dokumente:
- *A. K. punon në Greqi nga viti 1991 deri sot – shumën 5,000 euro ia ka sjellë kunatit të subjektit me bankë dhe ky i fundit ia ka dhënë subjektit;*
 - *S. M. ka qenë pronari i shoqërisë tregtare “***”, e regjistruar në QKR prej vitit 1999;*
 - *A. A. ka qenë pronar i shoqërisë tregtare “***”, e regjistruar në QKR prej vitit 2009 – më parë, ka qenë i regjistruar si person fizik prej vitit 1992;*
 - *A. Xh. ka punuar në Greqi dhe shumën e dhënë hua e ka tërhequr nga banka;*
 - *P. Xh. ka punuar në ekonominë e tij shtëpiake, veç të tjerave, në një kioskë.*
42. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se në rast se nuk do njihet marrja e huave, nuk duhet përfshirë në analizë edhe kthimi i tyre si shpenzim. Sipas tij, dyshimi për fiktivitet do të krijohet nëse ai nuk do t’i kishte kthyer huat të paktën deri në vitin 2016.
43. Në mbështetje të sa më sipër, subjekti ka paraqitur, në cilësinë e provave të reja, dokumentet në vijim:
- a. deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.2.2015, e lëshuar nga shtetasi P. Xh., i cili ka deklaruar se i ka dhënë hua kunatit të tij Tomorr Kullolli, në prill të vitit 2006, shumën prej 1,000,000 lekësh, pa interes dhe pa afat;
 - b. deklaratë noteriale nr. ***, datë 12.2.2015, e lëshuar nga shtetasja V. A., e cila ka deklaruar se i ka dhënë hua në mars të vitit 2006, të afërmit Tomorr Kullolli, shumën prej 2,000,000 lekësh, pa interes dhe pa afat, që t’ia kthejë sipas mundësive të tij financiare;
 - c. ekstrakt nga QKR-ja i shoqërisë “***” sh.p.k., e regjistruar në datën 26.1.2009, me aksionerë A. A., J. A. dhe V. A.;
 - d. certifikatë familjare e datës 12.3.2009, e familjes A., ku personat e sipërpërmendur janë fëmijët dhe bashkëshortja e shtetasit A. A.;

- e. ekstrakt nga QKR-ja e shoqërisë “***” sh.p.k., e regjistruar në datën 8.6.1997, me ortak të vetëm shtetasin S. M.;
- f. librezë kursimi e shtetasit A. Xh.

Vlerësimi i trupit gjykues

44. Fillimisht, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur vetëm dy deklarata noteriale prej pesë huadhënësve. Konkretisht: (i) për shtetasin P. Xh., subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave; (ii) për shtetasin A. A., subjekti ka deklaruar se ka ndërruar jetë dhe, për rrjedhojë, deklarimin e ka kryer e shoqja. Për të ardhurat, subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokumentacion provues. Referuar ekstraktit historik, shoqëria e familjes A. është regjistruar në fund të janarit të vitit 2009, pra, pas dhënies së huas në vitin 2006; (iii) për shtetasin S. M., subjekti ka paraqitur vetëm ekstraktin e shoqërisë “***” sh.p.k. Nga kontrolli në QKB nuk ka pasqyra financiare të publikuara për periudhën deri në vitin 2006, të dhënies së huas dhe nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion për të provuar të ardhurat e kësaj shoqërie apo dividendë të shpërndarë; (iv) për shtetasin A. Xh., librezë e kursimeve e sjellë nga subjekti rezulton të jetë në emër të shtetasit A. Xh., por, edhe nëse ajo do të ishte në emër të shtetasit A. Xh., disponibiliteti i shumës 10,000 euro nuk mjafton për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave që kanë shërbyer për huadhënien në favor të subjektit; si dhe (v) për shtetasin A. K. nuk është depozituar asnjë dokumentacion provues.
45. Nisur nga sa më lart, trupi gjykues konstaton se, përpos tentativës për të provuar burimet, nga dokumentacioni i paraqitur prej subjektit në seancën dëgjimore ka dështuar për sa kohë nga përmbajtja e këtij dokumentacioni nuk është provuar në mënyrë shteruese burimi i ligjshëm i asnjërit prej huadhënësve, por vetëm për dikë disponibiliteti financiar me burime të panjohura.
46. Për sa i përket pretendimit të subjektit që nëse Komisioni nuk do të konsiderojë me burim të ligjshëm dhe nuk do t’i përllogaritë në analizën financiare, atëherë nuk duhet të përfshihen/llogariten as shpenzimet, ndër vite, të deklaruara për kthimin pas të këtyre huave, pasi fiktiviteti i tyre çon në moskthim pas, trupi gjykues arsyeton si vijon:
- a- Komisioni nuk është shprehur dhe ka kaluar barrën e provës për ngritjen e dyshimeve mbi një fiktivitet të huave – për sa kohë subjekti i ka deklaruar si burime dhe si shpenzime në fazën e kthimit pas ndër vite – por është kërkuar të provohet burimi i ligjshëm i shumave të përfituara nga subjekti nëpërmjet huazimeve në fjalë. Në këto kushte, dështimi për të provuar burimin e ligjshëm të huadhënësve nuk passjell shuarjen e efekteve financiare të dhënies dhe kthimit të huas (sipas deklarimeve të subjektit), por vetëm moskonsiderimin si të ligjshme përfitimet nga huat dhe verifikimin e mundësive financiare për kthimin pas të tyre përgjatë viteve dhe në masat e deklaruara nga subjekti.
 - b- Megjithatë, trupi gjykues vëren se, edhe nëse do të pranohej kërkesa e subjektit për të mos i përllogaritur në analizën financiare shumat e deklaruara prej tij si shpenzime për kthimin pas ndër vite të huave, rezultati për periudhën e interesuar (2007 – 2011) do të përmirësohej me 3,107,245 lekë, por gjithsesi bilanci i përgjithshëm negativ do të

mbetej në nivele shumë të larta, ndonëse i përmirësuar. Nga ana tjetër, edhe në rast se do gjendej i bazuar ky pretendim i subjektit, nuk do të ndryshonte asgjë lidhur me burimet financiare për pasurinë në analizë, pasi sërish do të konsistonte në një pamundësi financiare në masën 6,708,671 lekë, për sa kohë kthimi i huave është kryer në vitet e mëpasme.

3. Apartament me sipërfaqe 134 m², ndodhur në S., Tiranë

47. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2014, me vlerën 69,371 euro, por pa përshkruar burimin e krijimit, ndërsa në deklaratën *Vetting* është deklaruar burimi financiar nga të ardhurat familjare.
48. Pasuria rezulton të jetë përfituar me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 25.4.2014, të lidhur midis shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k. dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. L. K., për blerjen e këtyre pasurive:
 - a. apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në z. k. ***, me sip. 70.6 m², kundrejt çmimit 33,009 euro;
 - b. apartament me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, në z. k. ***, me sip. 63.6 m², kundrejt çmimit 36,362 euro.
49. Nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, ka rezultuar se më herët në datën 8.12.2011, të njëjtat palë kishin nënshkruar një tjetër kontratë për ndërtim apartamenti me nr. *** prot., të lidhur midis shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k. dhe palës blerëse L. K., për porositjen e një apartamenti me sip. 159.7 m², kundrejt çmimit total prej 155,707.5 euro, nga ku kësti i parë në vlerën 107,600 euro do të paguhej me nënshkrimin e kontratës, ndërsa pjesa tjetër prej 48,107.5 euro do të likuidohej deri në datën 15.1.2012.
50. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 – pasi është pyetur nga Komisioni mbi arsyet e mosdeklarimit të kësaj pasurie dhe pagesës së kryer në DIPP-në e vitit 2011 dhe në vijim – subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se kjo kontratë nuk është deklaruar, pasi është anuluar dhe se ka deklaruar vetëm pasurinë e regjistruar. Bashkë me përgjigjet, subjekti ka paraqitur një revokim kontrate me nr. *** prot., datë 25.9.2012, me shoqërinë ndërtuese “***” sh.p.k., në të cilën palët janë shprehur se për shkak të pozicionit të apartamentit, pala porositëse do të rezervonte një apartament tjetër dhe shuma e parapaguar prej 59,000 euro, do të përdorej për rezervimin e një apartamenti të ri.
51. Komisioni iu drejtua sërish subjektit të rivlerësimit me anë të pyetësorit nr. 3, për të bërë me dije arsyet e mosdeklarimit në DIPP-në e vitit 2011 të kontratës së porositjes së apartamentit dhe kryerjes së pagesës prej 59,000 euro, për sa kohë revokimi i kontratës është kryer 1 vit më pas, si dhe për të listuar dhe paraqitur të gjitha mandatpagesat për likuidimin e apartamentit në fjalë, duke shpjeguar, gjithashtu, cili ishte burimi i të ardhurave të përdorura për kryerjen e kësaj pagese në vitin 2011.
52. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se nuk disponon mandatpagesa, ndërsa burimi i të ardhurave ka qenë sipas deklarimeve që ka bërë, ndër vite, duke mos depozituar ndonjë dokumentacion provues të burimeve financiare në fjalë.
53. Lidhur me këtë pasuri, Komisioni ka administruar dokumentacionin si vijon:

- i. ASHK Tirana Rurale, me shkresën nr. *** prot., datë 27.1.2020, ka konfirmuar se në emër të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, rezultojnë të regjistruara dy pasuritë e paluajtshme të llojit apartament me nr. pasurie *** dhe ***, në z. k. ***;
- ii. certifikatat për vërtetimin e pronësisë për pasuritë e llojit apartament me sip. 63.6 m², nr. *** dhe apartament me sip. 70.06 m², nr. ***, në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. L. K., të lëshuara në datën 22.5.2014²⁰;
- iii. kontratë shitblerje nr. ***, datë 25.4.2014, lidhur midis shoqërisë ndërtuese “****” sh.p.k dhe bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, znj. L. K., për blerjen e dy apartamenteve kundrejt çmimit total 69,371 euro;
- iv. UKT-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 18.2.2020, ka informuar se në emër të bashkëshortes së subjektit, znj. L. K., figuron e regjistruar kontrata e abonentit familjar me nr. ***, e hapur në datën 12.5.2014, me adresë “K. D.”, Tiranë, për çeljen e së cilës është depozituar kontrata për ndërtim apartamenti me nr. *** prot., datë 8.12.2011.

3.1 Lidhur me analizimin e burimeve të krijimit të kësaj pasurie

- 54. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* si burim të krijimit të kësaj pasurie të ardhurat familjare. Nga shqyrtimi i deklaratave periodike të dorëzuara nga subjekti, është konstatuar se duke filluar nga DIPP-ja e vitit 2003 dhe në vijim deri në DIPP-në e vitit 2013, nuk ka deklaruar disponimin në banesë të ndonjë gjendje monetare *cash*, likuiditete apo kursime që të mund të përdreshin për blerjen e kësaj pasurie.
- 55. Në këto kushte, duke u bazuar në kontratën e revokimit të datës 25.9.2012, në të cilën palët kanë deklaruar se shuma e dhënë prej 59,000 euro do të përdorej si parapagim për apartamentin e ri, Komisioni përlllogariti mundësinë e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e kësaj pagese në vitin 2011. Nisur nga fakti që pagesa në favor të palës shitëse të pasurive në fjalë është kryer *cash* nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni përlllogariti të gjitha fondet e tërhequra nga llogaritë bankare të tij dhe të bashkëshortes përgjatë vitit 2011, të cilat rezultuan në masën 1,203,500 lekë.
- 56. Pas përlllogaritjes së shpenzimeve²¹ të familjes gjatë vitit 2011, ka rezultuar se për kryerjen e pagesës në shumën prej 59,000 euro (ekuivalenti në shumën prej 8,159,700 lekësh), subjekti ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare prej – 7,512,680 lekësh, siç është detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3 – Analiza e burimeve të përdorura për pagesën e kësaj pasurie

²⁰ Bashkëngjitur dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja janë edhe mandatpagesat për regjistrimin e pasurive të paguara nga shtetasja L. K., në vlerën totale 25,961 lekë.

²¹ Shpenzimet e jetesës për një familje me katër pjesëtarë, referuar të dhënave zyrtare të INST AT dërguar nga ILDKPKI dhe 10,000 lekë për shpenzimet e arsimit të fëmijëve, bazuar në shkresën nr. *** prot., të shkollës jopublike “I. L.”, Elbasan. Kjo e fundit ka bërë me dije se shpenzimet e shkollimit për të dy fëmijët për vitin 2011 kanë qenë 100,000 lekë, nga të cilat 90,000 lekë janë kryer me anë të transfertave bankare nga llogaria e bashkëshortes së subjektit L. K. Po ashtu, pagesat e kredisë janë kryer nga llogaria bankare e subjektit dhe për këtë arsye nuk janë përlllogaritur shpenzime të kredisë në këtë analizë.

Fondet e tërhequra gjatë 2011	1 203 500
Pagesë kësti I-rë apartamentit në Tiranë	(8 159 700)
Shpenzime të vitit 2011	(556 480)
Rezultati	(7 512 680)

57. Në kontratën përfundimtare të shitblerjes, palët kanë deklaruar se çmimi total i pasurive ka qenë në vlerën 69,371 euro dhe është likuiduar jashtë zyrës noteriale. Për këtë arsye, Komisioni përllorarit mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes, për të kryer pagesën e diferencës së çmimit prej 10,371 euro (69,371-59,000 të parapaguara në 2011), në datën e kryerjes së transaksionit më 25.4.2014. Nga shqyrtimi i veprimeve bankare të subjektit dhe të bashkëshortes, përgjatë periudhës 1.1.2014 – 25.4.2014, ka rezultuar se kanë kryer tërheqjet nga llogaritë e tyre, në shumën totale prej 288,000 lekësh.
58. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2014 shitjen e gjysmës së aksioneve të tij në shoqëritë “****” sh.a. dhe në “****” sh.a., në shumat përkatësisht 2,755,200 lekë dhe 1,028,500 lekë, si dhe ka vënë në dispozicion kontratat me nr. ***, datë 17.4.2014²² dhe nr. ***, datë 17.4.2014, të lidhura ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe blerësit Sh. K.²³. Këto aksione janë deklaruar fillimisht nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-në e vitit 2003, përkatësisht 5,760 aksione në shoqërinë aksionare “****”, me vlerë 576,000 lekë dhe aksione në masën 2% në shoqërinë aksionare “****”, me burim krijimi nga letra me vlerë të trashëguara.
59. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, në të cilin subjekti i rivlerësimit është ftuar të sqaronte dhe të paraqiste dokumentacionin ligjor në bazë të të cilit është ftuar pronësia mbi letrat me vlerë dhe më pas mbi aksionet në këto shoqëri, është shprehur se letrat me vlerë janë marrë nga babai, xhaxhai dhe gjyshi i tij si shpërblim për burgim të padrejtë, pasi kanë qenë të burgosur politikë. Subjekti ka shpjeguar se këto letra i ka regjistruar më pas në blerjen e aksioneve në këto shoqëri, por nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës.
60. Komisioni iu drejtua sërish subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3, duke i kërkuar të paraqiste dokumentacionin ligjor me anë të të cilit kishte përfituar të drejtën mbi këto letra me vlerë, në emër të babait/gjyshit/xhaxhait dhe vlerën përkatëse, të cilat më pas janë përdorur prej tij për blerjen e aksioneve të sipërpërmendura. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti është shprehur se: “*Sqaroj se unë nuk kam blerë letra me vlerë, këto letra me vlerë të cilat janë përdorur për blerje aksionesh me ankand të mbyllur në vitin 1995 (për blerje aksionesh të ndërmarrjet *** Elbasan dhe *** Elbasan), i ka përfituar babai im H. K. dhe gjyshi im M. K., si dëmshpërblim si të dënuar politik, ndërsa unë kisha letrat me vlerë të D. K., si trashëgimtar i tij*”.
61. Subjekti, së bashku me përgjigjen e mësipërme, ka bashkëngjitur dokumentacionin: (i) formular kërkesë për blerje aksionesh në ndërmarrjen “**** “, Elbasan, datë 25.10.1995,

²² Konstatohet se kontratat e vëna në dispozicion nga subjekti bashkëngjitur deklaratës *Vetting* kanë të shënuar datën 2013 me shifra dhe 2014 me shkronja.

²³ Shtetasi rezultoi të jetë vëllai i subjektit të rivlerësimit dhe në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka bërë me dije se, meqenëse blerësi i aksioneve ishte vëllai dhe palët janë likuiduar për blerjen e aksioneve, ata nuk kanë mbajtur dokumentacion për shlyerjen.

ku ka paguar 1,000,000 lekë privatizimi; (ii) formular kërkesë për blerje aksionesh në ndërmarrjen “****” Elbasan, datë 20.12.1995, ku ka paguar 1,230,401 lekë privatizimi.

62. Në përfundim, duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues për legjitimitimin e tij mbi përfitimin e të drejtave mbi letrat me vlerë të babait, gjyshit dhe xhaxhait, në mënyrë që t’i regjistronte/përdorte ato më pas për blerjen e aksioneve në emër të tij. Gjithashtu, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi vlerën e tyre, por ka depozituar vetëm shumën e investuar prej tij në blerjen e aksioneve me anë të formularëve, të cilët nuk janë të shoqëruar me urdhërshirimet e përmendura në këto formularë.
63. Për sa kohë që mbetet e paprovuar ligjshmëria e burimit të përdorur nga subjekti për blerjen e aksioneve në fjalë, Komisioni, në këtë fazë, nuk ka konsideruar të ligjshme edhe përfitimet e tij, ndër vite, nga këto aksione.
64. Lidhur me të ardhurat nga shitjet e aksioneve të zotëruara në shoqëritë e sipërpërmendura, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit, nëpërmjet pyetësorit nr. 2, për të paraqitur dokumentacionin ligjor që të provojë pagimin e detyrimeve tatimore për fitimet e realizuara nga këto shitje, subjekti nuk ka dhënë shpjegime dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokument.
65. Nga dokumentacioni i administruar/disponuar nga Komisioni²⁴ është konstatuar se subjekti i rivlerësimit në vitin 1996, që është bërë privatizimi i shoqërisë, ka blerë 7,050 aksione në shoqërinë aksionare “****”, me lekë privatizimi në shumën 1,230,401 lekë. Në momentin e shitjes së pjesës së aksioneve, vlera e tyre ka qenë 5,512,020.84 lekë.
66. Po ashtu, në shoqërinë aksionare “****”, subjekti ka blerë fillimisht 663 aksione kundrejt vlerës 663,000 lekë, ndërkohë që në momentin e shitjes në vitin 2014, vlera e tyre ka qenë 2,057,380 lekë.
67. Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti ka pasur detyrimin për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave ose aksioneve në këto shoqëri.
68. Për sa kohë, mbeten të paprovuara me dokumentacion ligjor pagesat e detyrimeve tatimore lidhur me fitimet e realizuara nga shitja, në këtë moment, Komisioni bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, nuk i ka konsideruar këto të ardhura me burim të ligjshëm në analizën financiare.
69. Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e aksionerit pasiv, ka caktuar më pas shtetasin K. H. si *person të besuar* për të marrë pjesë në mbledhjet e shoqërive aksionare “****” dhe “****”, si dhe për interesimin e aksioneve, por duke ruajtur të drejtën për përfitimin e fryteve civile nga këto shoqëri, me anë të aktmarrëveshjes nr. ***, datë 31.3.2015²⁵.
70. Përgjatë hetimit administrativ është konstatuar se Agjencia e Prokurimit Publik me shkresën nr. *** prot., datë 14.7.2017, ka informuar se shoqëria aksionare “****” sh. a.,

²⁴ Raport mbi shpërndarjen e aksioneve të shoqërisë së datës 2.2.1996, bashkëngjitur vendimeve të gjykatës për regjistrimin e personit juridik “****” sh. a. në www.qkb.gov.al

²⁵ Nuk rezulton që kjo aktmarrëveshje e datës 31.3.2015 të jetë reflektuar në ekstraktet historike të shoqërive respektive dhe në mbledhjet e asambleve të aksionerëve pas kësaj date.

është shpallur fitues në procedurat e prokurimit në vitet 2011, 2013, 2014, 2015 dhe 2016, me fond total prej 293,938,270 lekësh.

71. Nisur nga sa më sipër, duket se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka qenë zotërues aktiv i aksioneve të shoqërive “***” sh.a. dhe “***” sh.a., ndërkohë që ishte duke ushtruar detyrën e gjyqtarit, fakt ky që përbën shkak papajtueshmërie me funksionin e gjyqtarit, pasi sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, në kreun III, seksionin 2, nenin 26, pikën 2, parashikohet se: *“Për zyrtarët e tjerë, të patrajtuar në këtë seksion, zbatohen kufizime të përcaktuara në ligje të veçanta për të njëjtin qëllim. Kur me ligj përcaktohet se këta zyrtarë nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari private, kjo kupton edhe ndalimin e zotërimit në mënyrë aktive të aksioneve ose pjesëve në kapital në shoqëritë tregtare në ato kushte për të cilat ndalohet veprimtaria private”, si dhe bazuar në ligjin nr. 9877, datë 18.2.2008, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 22, “Papajtueshmëritë me detyrën e gjyqtarit”, cilësohet se: *“Gjyqtari nuk mund të ushtrojë asnjë veprimtari tjetër shtetërore, private ose politike”*²⁶.*
72. Gjithashtu, duket se subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit, sipas ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, me ligjin nr. 44/2014, neni 21, ku citohet se: *“Asnjë individ, kur ky njehsohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 të këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit, dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik.”*, për sa kohë shoqëria “***” sh.a., ku z. Tomorr Kullolli ka qenë aksioner, ka përfituar nga fondet publike.
73. Po ashtu, ka rezultuar se bashkëshortja²⁷ e subjektit të rivlerësimit ka regjistruar aktivitetin e saj në shoqërinë “***” sh.p.k., në datën 13.9.2013, në të cilin zotëronte fillimisht 50% të aksioneve dhe më pas në mars të vitit 2017²⁸ ka blerë edhe pjesën tjetër të aksioneve të kësaj shoqërie.
74. Ndërkohë, DPT-ja i ka bërë me dije Komisionit, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 6.3.2020, se shoqëria “***” sh.p.k.,²⁹ gjatë vitit 2014, ka realizuar të ardhura në masën 3,865,895 lekë dhe fitim pas tatimit në masën 1,742,520 lekë. DPT-ja ka informuar

²⁶ Po ashtu, ligji nr. 8436, datë 28.12.1998. “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 30 citon se: *“Funksioni i gjyqtarit është i papajtueshëm me çdo mandat zgjedhor, si dhe me çdo funksion dhe veprimtari tjetër publike ose private. Gjyqtarëve u ndalohet të marrin pjesë në administrimin apo drejtimin e shoqërive civile ose tregtare, personalisht ose me anë përfaqësimi”*. Po ashtu, referuar nenit 143 të Kushtetutës së Shqipërisë: *“Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit”*.

²⁷ Në DIPP-në të vitit 2013, subjekti ka deklaruar të ardhura në shumën 6,000,000 lekë nga shitja e pasurisë së llojit “tokë arë” të bashkëshortes. Nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se bashkëshortja e subjektit së bashku me familjen e saj të origjinës kanë përfituar këtë tokë në zbatim të ligjit nr. 7501. Më pas, në datën 26.12.2012, familjarët kanë bërë ndarjen e kësaj pasurie me kontratë pjesëtimi vullnetar, sipas të cilës bashkëshortja e subjektit do të përfitonte një sipërfaqe prej 2,012 m² nga sipërfaqja totale prej 7,045 m², të cilën e ka shitur me kontratën nr. ***, datë 10.9.2013, vëllait dhe kumatës të saj, kundrejt çmimit 6,000,000 lekë. Po ashtu, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit rezulton të jetë bashkëpronare në një apartament të përfituar me anë të privatizimit, me sip. 31 m², së bashku me familjen e saj të origjinës, të cilin nuk e ka deklaruar në asnjë nga DIPP-të ndër vite dhe as në deklaratën Vetting.

²⁸ Me anë të kontratës së shitjes së kuotave, datë 24.3.2017, ortakut B. K. i ka shitur L. K. pjesën e tij të aksioneve me vlerë nominale 50,000 lekë, kundrejt çmimit total prej 10,000 lekë. Përveç kësaj kontrate, bashkëshortja e subjektit ka depozituar në QKB edhe vendimin e asamblesë së ortakëve së datës 24.3.2017, ku është aprovuar largimi i ortakut B. K..

²⁹ Bashkë me përgjigjet e pyetësorit nr. 3, subjekti ka paraqitur bilancet dhe deklaratat e tatim-fitimit të thjeshtuar të shoqërisë për vitet 2014 e në vijim.

gjithashtu, se bazuar në Udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006, të ndryshuar, duke qenë se shoqëria është biznes i vogël me përgjegjësi tatimore për tatim të thjeshtuar, nuk ka detyrimin për të depozituar vendim mbi destinimin e fitimit/tërheqje dividendi.

75. Në këto kushte, Komisioni ka përllogaritur në mënyrë përpjestimore, në raport me fitimin total, të ardhurat nga fitimet e kësaj shoqërie për një periudhë 4-mujore, në masën 290,420 lekë³⁰ dhe të ardhura nga paga³¹ e saj në këtë shoqëri për të njëjtën periudhë.
76. Pas përllogaritjes së shpenzimeve të familjes së subjektit të rivlerësimit, ka rezultuar mungesë e burimeve të ligjshme financiare për pagesën e kësaj pasurie në vitin 2014, në masën 1,042,660 lekë.

Tabela nr. 4 – Analiza e burimeve të përdorura për pagesën e kësaj pasurie

Fondet e tërhequra janar-25.04.2014	288 000
Të ardhura nga aktiviteti b/shortes	290 420
Të ardhura nga paga b/shortes	106 560
Pagesa kësti II-të apartamentit në Tiranë	(1 434 309)
Shpenzime jetese janar-prill 2014	(293 331)
Rezultati	(1 042 660)

77. Në përfundim të hetimit administrativ, nisur nga sa më sipër, Komisioni i ka kaluar barrën e provës subjektit lidhur me rezultatet që vijnë:

- *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2011 lidhjen e kontratës paraprake me shoqërinë shitëse “***” sh.p.k. për ndërtimin e një apartamenti dhe as pagesën e kryer në atë vit, si paradhënie.*
- *Duket se ka një diferencë të pajustificuar midis çmimeve të apartamenteve të porositura në vitin 2011 dhe të blera në vitin 2014, pasi fillimisht janë porositur me 975 euro/m² dhe më pas janë blerë me 517 euro/m².*
- *Duket se për kryerjen e pagesës së kësaj pasurie të apartamenteve të ndodhura në rr. “K. D.”, Tiranë, në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme, në masën 7,512,680 lekë.*
- *Duket se për kryerjen e pagesës së kësaj pasurie të apartamenteve të ndodhura në rr. “K. D.”, Tiranë, në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme, në masën 1,042,660 lekë.*
- *Duket se subjekti i rivlerësimit, duke filluar nga viti 2005, ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit për sa kohë ka zotëruar në mënyrë aktive aksione në shoqëritë “***” sh.a. dhe “***” sh.a. deri në vitin 2015, ndërkohë që ishte duke ushtruar edhe detyrën e gjyqtarit. Po ashtu, duket se subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të*

³⁰ Janë përllogaritur 50% të fitimeve (në raport me % e aksioneve të zotëruara në shoqëri) për periudhën 4-mujore, në raport me fitimin total *neto* të realizuar nga shoqëria.

³¹ Bazuar në vërtetimin nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, është konfirmuar se nga shoqëria “***” sh.p.k. janë paguar kontributet e sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe TAP për bashkëshorten e subjektit për pagën *bruto* në shumën 30,000 lekë/muaj. Komisioni ka njohur në analizën financiare, për vitet 2014 – 2016, të ardhurat nga paga e saj. Të ardhura nga paga për vitin 2013 nuk janë konsideruar në analizë, pasi zëri i shpenzimeve të pagave rezultoi 0 në bilancin e dorëzuar për këtë vit.

*interesit për vitet 2014 – 2016, pasi shoqëria “***” sh.a. ka përfituar tendera nga fondet publike.*

- *Duket se të ardhurat e përfituara nga pronësia mbi aksionet e shoqërive “***” sh.a. dhe “***” sh.a., nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk ka rezultuar e provuar, deri më tani, ligjshmëria e përfitimit fillestar të tyre nga ana e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, edhe të ardhurat e realizuara nga shitja e një pjese të aksioneve, nuk mund të konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk është kryer pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

78. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrative të kryer nga Komisioni, nëpërmjet shpjegimeve të depozituara është shprehur se pagesën në shumën 59,000 euro në vitin 2011, nuk e kujton, pasi kontrata është anuluar, por pagesa është kryer nga shuma e përfituar nga dhurimi i babait të tij, në shumën prej 9,300,000 lekësh. Sipas pretendimeve të tij, kjo shumë i është dhënë subjektit më herët, ndonëse deklarata noteriale është bërë në dhjetor të vitit 2012, pasi ka pasur për qëllim vetëm dokumentimin e dhurimit, në një moment të dytë.
79. Ndonëse në vitin 2012, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*, si pasojë e pagesës së kryer për këtë pasuri prej kësaj shume, pasi nëse do ta kishte përfituar/marrë në dhjetor të vitit 2012 dhurimin, nuk do kishte pasur mundësi ta shpenzonte, duke zeruar gjendjen *cash*.
80. Lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të babait të tij, që kanë mundësuar dhurimin e shumës prej 9,300,000 lekësh, subjekti ka pretenduar se ajo është provuar me vendimin e pushimit të hetimit në procedimin penal ndaj tij, nga prokuroria dhe gjykata.
81. Sipas subjektit, për pagesën e kryer në vitin 2014, kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e tokës së bashkëshortes në vitin 2013, në shumën 6,000,000 lekë dhe shuma e mbetur nga dhurimi i kryer nga babai prej 9,300,000 lekësh. Gjithashtu, subjekti ka pretenduar se me deklarimin e të ardhurave, ndër vite, ka vlerësuar se në këtë mënyrë ka deklaruar edhe faktin që një pjesë ose totalin e tyre e ka pasur gjendje *cash* në fund të vitit.

Vlerësimi i trupit gjykues

82. Trupi gjykues vlerëson se, ndonëse subjekti është pyetur në mënyrë të përsëritur dhe ka pasur mjaftueshëm kohë në dispozicion, përshi edhe kohën shtesë që kërkoi dhe iu dha, nuk ka paraqitur prova direkte mbi burimet e ligjshme financiare për pagesat e kryera për këtë pasuri, madje ka anashkaluar këtë detyrim që mbart në cilësinë e subjektit të rivlerësimit, duke i referuar/cituar në mënyrë të përgjithshme Komisionit ekzistencën e vendimeve penale, që sipas tij kanë konstatuar ligjshmërinë e burimeve financiare për krijimin e pasurive të tij. Trupi gjykues, sikurse është shprehur edhe më herët, përfshi edhe përgjatë seancës dëgjimore të datës 7.6.2021, çmon se kjo nuk është një qasje bashkëpunuese dhe se pretendimet e subjektit nuk qëndrojnë për sa kohë vlerësimi/verifikimi/hetimi i kryer në aspektin penal ka si objekt konstatimin ose përjashtimin e ekzistencës të elementëve të veprave penale, që lidhen me deklaratimet e pasurisë apo me paligjshmërinë pasurore. Ndërkohë që, siç subjekti duhet ta ketë pasur

në vëmendje, hetimi administrativ për shkak të rivlerësimit kalimtar të subjekteve të ligjit nr. 84/2016, synon vetëm në verifikimin burimit të ligjshëm të shumave monetare apo pasurive të krijuara, të poseduara apo të tjetërsuara nga subjektet e rivlerësimit – përpos saktësisë së deklarimeve përkatëse. Për rrjedhojë, për sa kohë gjendemi në dy rrafshë të ndryshme jo vetëm të së drejtës (administrative dhe penale), mbi të cilën mbështetet secili prej proceseve të sipërcituar, por edhe të objekteve të ndryshëm – përpos procedurave natyrshëm të ndryshme – atëherë, nisur nga pozicioni funksional i subjektit të rivlerësimit, nuk mund të kryhet një konfuzion dhe mbivendosje midis tyre. Për sa kohë dispozitat kushtetuese dhe ligjore parashikojnë detyrimin e subjekteve për të përmbysur barrën e provës, duke paraqitur në procesin e rivlerësimit prova konkrete, specifike dhe ligjore mbi burimet e ligjshme të pasurive të tyre, ky detyrim nuk mund të anashkalohet me referim të akteve të një tjetër natyre juridike (madje pa i paraqitur ato), dhe as me kërkesa “deleguese” ndaj Komisionit, për t’i gjetur dhe konsideruar si prova shteruese ato.

83. Përpos sa më sipër, lidhur me analizimin e përmbajtjes së deklaratës noteriale të lëshuar nga babai i subjektit mbi dhurimin e shumës prej 9,300,000 lekësh, konstatohet se babai shprehet qartë të ketë dorëzuar shumë monetare në duart e subjektit pas datës 9.12.2012, datë e cila lidhet me bashkimin të tyre në një banesë pas vdekjes së bashkëshortes të dhuruesit (pikërisht, më 9.12.2012) dhe, për rrjedhojë, kjo shumë nuk mund të konsiderohet si burim i disponueshëm për pagesën e kryer në vitin 2011.
84. Po ashtu, të ardhurat nga shitja e tokës së bashkëshortes së subjektit në vitin 2013, për sa kohë nuk është deklaruar apo provuar kursimi i tyre dhe disponimi në gjendje *cash*, deri në vitin 2014, edhe ky burim pretenduar nuk mund të konsiderohet disponibilitet financiar i përdorshëm për kryerjen e pagesës së kështit të dytë, për pasurinë në analizë.
85. Për rrjedhojë, në konkluzion lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues çmon se prej subjektit nuk janë paraqitur prova mbi burime financiare të ligjshme shtesë – veç atyre që Komisioni ka vlerësuar – dhe se rezultatet e hetimit administrativ të njoftuara nuk mund të ndryshojnë, duke konfirmuar një pamundësi financiare të subjektit në vlerën negative prej 7,512,680 lekësh në vitin 2011 dhe prej 1,042,660 lekësh në vitin 2014.

4. Automjet tip “Mercedes Benz”, me targa ***

86. Kjo pasuri është deklaruar për herë të parë në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, me vlerë 600,000 lekë dhe me burim krijimi nga kursimet nga paga.
87. DPSHTRr-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 27.7.2017, ka konfirmuar se në pronësi të subjektit të rivlerësimit figuron i regjistruar automjeti me targa ***. Me shkresën nr. *** prot, datë 17.7.2017, DPSHTRr-ja Elbasan ka bashkëngjitur dosjen e automjetit në fjalë.
88. Ky automjet është blerë prej subjektit të rivlerësimit me kontratën e shitblerjes të lidhur me shtetasin J. H. D., kundrejt çmimit 3,000 marka gjermane³². Referuar kontratës, veprimet për kalimin e pronësisë janë përfunduar në datën 30.10.2001 dhe vlera e zhdoganimit të mjetit prej 153,527 lekësh, është paguar nga subjekti i rivlerësimit Tomorr

³² Në dokumentin e zhdoganimit rezulton të jetë edhe kursi i këmbimit 1 DEM = 66.15 lekë.

Kullolli në datën 5.11.2001, nga ku vlera totale e blerjes dhe zhdoganimit duket të ketë qenë në shumën 351,977 lekë.

89. Komisioni ka përlogaritur mundësitë e subjektit të rivlerësimit me të ardhurat e tij nga pagat për periudhën 1996 – tetor të vitit 2001, momenti kur janë kryer pagesat për blerjen dhe zhdoganimin e mjetit dhe pasi janë zbritur shpenzimet jetike³³ ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi për kryerjen e pagesave në fjalë, me burime të ligjshme financiare, siç është detajuar në tabelën më poshtë.

Tabela nr. 5 – Analiza e burimeve të përdorura për blerjen e pasurisë

Të ardhura 1996-tetor 2001	2,022,381
Shpenzime jetese 1996-tetor 2001	(1,619,980)
Blerë automjeti AA***EC	(351,977)
Rezultati	50,424

90. Nga sa më sipër, përgjatë hetimit administrativ lidhur me këtë pasuri, është konstatuar një mospërputhje midis vlerës së blerjes së automjetit në deklaratet e subjektit në DIPP-në e vitit 2003 dhe në deklaratën *Vetting*, krahasuar me vlerën e përshkruar në kontratën e shitblerjes dhe aktin e zhdoganimit dhe se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi për blerjen e pasurisë, në vitin 2001, me burime të ligjshme financiare.

5. Lidhur me dhurimin e shumës 9,300,000 lekë, të pretenduar nga subjekti si të përfituar nga babai i tij

91. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2012 dhurimin e shumës prej 9,300,000 lekësh nga babai i tij, sipas deklaratës noteriale nr. ***, datë 31.12.2012.
92. Po ashtu, në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si dhuratë nga babai i tij edhe shumën prej 400,000 lekësh – me burim nga dëmshpërblimi i përfituar nga dhuruesi.
93. Në deklaratën noteriale të sipërcituar të datës 31.12.2012, babai i subjektit të rivlerësimit H. K., ka deklaruar se pas bashkimit me djalin e tij në datën 9.12.2012, i ka dhuruar shumën prej 9,300,000 lekësh të kursyer gjatë gjithë jetës, pasi në vazhdimësi pas vdekjes së bashkëshortes do të jetonin së bashku. Në këtë deklaratë nuk është përmendur dhurimi i shumës prej 400,000 lekësh, i deklaruar nga subjekti në DIPP-në e vitit 2011.
94. Nëpërmjet pyetësorit nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bënte me dije dhe të paraqiste dokumentacionin ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të babait, të cilat kanë mundësuar kursimin prej tij të shumës 9,700,000 Lekë, të dhuruar subjektit. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të kërkesës së lartpërmendur, është shprehur se për këtë deklaratë, është kallëzuar në prokurori nga ILDKPKI-ja dhe ka paraqitur vendimin, datë 26.10.2015, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Për pushimin e procedimit penal të çështjes nr. *** të vitit 2015” dhe vendimin nr. *** regj., datë 11.2.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “kundërshtimin e vendimit për pushimin e procedimit penal nr. ***, datë 26.10.2015 të

³³ Nga Komisioni janë përlogaritur shpenzimet jetike sipas të dhënave zyrtarë të INST AT për vitet 2001 dhe 2000, në masën 5,000 lekë/ muaj për frymë për vitet 1997 – 1999 dhe me 66% të të ardhurave për vitin 1996, bazuar në jurisprudencën e KPA-së.

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë”. Ndërsa, për shumën prej 400,000 lekësh të dhuruar në vitin 2011, subjekti ka bërë me dije se ishte marrë nga babai si dëmshpërblim.

95. Komisioni iu ridrejtua subjektit të rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 3, duke i rikërkuar të vendosë në dispozicion të dokumentacionit për të provuar të ardhurat e babait të tij, të cilat nuk ishin paraqitur së bashku me përgjigjet e mëparshme, si dhe të bëjë me dije nëse shumat e dhuruara ishin depozituar prej babait të tij në ndonjë bankë apo institucion tjetër financiar nga momenti i krijimit të tyre deri në momentin e dhurimit. Subjekti, në përgjigje të sa më sipër, është shprehur se: “[...] Për sa i përket pikës dytë të gjitha deklaratat noteriale janë paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Gjithashtu, personat që kanë lëshuar këto deklaratat noteriale janë paraqitur fizikisht në këtë prokurori dhe janë pyetur. Sa i përket të ardhurave të babait tim përveç sa kam deklaruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, babai im në vitin 1999 apo 2000 nuk më kujtohet saktë viti, ka marrë si i dënuar politik nga Enti Banesave Elbasan, vlerën (para kesh) e një apartamenti në qytetin e Elbasanit. Nuk di që babai të ketë investuar në ndonjë bankë”. Nuk është paraqitur ndonjë dokumentacion provues mbi shumat, kohën dhe mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga babai.
96. Për të vërtetuar shpjegimet e subjektit, lidhur me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për dhurimin e shumës prej 9,700,000 lekësh nga babai, Komisioni³⁴ iu drejtua Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 12.11.2020, ka vënë në dispozicion fashikullin e plotë të materialit kallëzues nr. ***, të vitit 2015.
97. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ardhur në materialin kallëzues, është konstatuar se në procesverbalin e mbajtur në datën 25.2.2015 në ILDKPKI-së, subjekti është pyetur nga kjo e fundit për aftësitë financiare të babait për të dhuruar shumën prej 9,300,000 lekësh. Në përgjigje të kësaj pyetje, subjekti është shprehur se babai ka dhënë me qira kullotën dhe ka përfituar të ardhura nga toka ndër vite. Në këtë material janë konstatuar deklaratat e mëposhtme:
- a) Shtetasi T. V. K., me deklaratën noteriale nr. ***, datë 6.10.2015, ka deklaruar se: “[...] tokën dhe shtëpinë e kushëririt tim H. K. e kam shfrytëzuar unë dhe për këtë i kam dhënë që nga viti 1994 e në vazhdim, për çdo vit 150,000 Lekë në vit, deri në vitin 2014 kur ai ka vdekur [...]”.
- b) Shtetasi F. B., me deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.9.2015, ka deklaruar se: “[...] që prej vitit 1996 e deri në vitin 2014, kam kullotur bagëtitë e mia në sipërfaqen e tokës kullotë të shtetasit H. K., për të cilën kam paguar vlerën prej 200,000 Lekë të reja në vit. [...]”.
98. Në relacionin për përfundimin e hetimit të kryer në datën 23.10.2015 nga prokuroria, subjekti është shprehur se për shkak se babai ka qenë në proces gjyqësor për marrjen e tokave dhe në mungesë të dokumenteve të pronësisë, nuk ka mundur të nënshkruajë

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2020.

kontrata qiraje dhe të paguajë tatimet përkatëse për këto të ardhura. Po ashtu, në dosje janë administruar edhe vërtetimet e pensioneve³⁵ të pleqërisë për shtetasit D. dhe H. K..

99. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni³⁶, ka rezultuar se shtetasi H. K. është trajtuar me pension pleqërie nga viti 1988 – 2014, në masën përfundimtare prej 19,344 lekësh, ndërsa nëna e subjektit, znj. D. K., është trajtuar më pension pleqërie nga viti 1981– 2012, në masën përfundimtare prej 18,000 lekësh.
100. Gjithashtu, Komisioni iu ridrejtoi ISSH-së³⁷ për të bërë me dije mbi shumën e saktë të përfituar nga pensionet e pleqërisë nga shtetasit e mësipërm deri në fund të vitit 2012, e cila me shkresën nr. *** prot., datë 17.11.2020, ka përcjellë këtë shkresë për DRSSH-në Elbasan për të dërguar informacionin e kërkuar.
101. Në përgjigje të kërkesave³⁸ të mësipërme, Drejtoria Rajonale Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2021, ka bërë me dije se babai i subjektit ka përfituar pension pleqërie deri në fund të vitit 2012, shumën totale prej 2,231,217 lekësh³⁹, po ashtu, nëna e subjektit të rivlerësimit ka përfituar pension pleqërie deri në fund të vitit 2012, në shumën totale prej 2,332,889 lekësh⁴⁰.
102. Po ashtu, Komisioni i ka kërkuar Entit Kombëtar të Banesave⁴¹, të bëjë me dije mbi përfitime të mundshme të babait të subjektit si i përndjekur politik apo nga programe të ndryshme strehimi. EKB-ja Elbasan me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2020, ka informuar se shtetasi H. K. ka përfituar si ish-përndjekur politik sipas shkresës së EKB-së Tiranë të datës 20.1.2000 dhe shkresës së Institutit të Përndjekurit Politik me nr. ***, datë 18.1.2000, me fond 1,260,000 lekë, me datë kontrate më 4.3.2000, për strukturë 2+1.
103. Nga shqyrtimi i lëvizjeve të llogarive bankare të babait të subjektit është konstatuar se ka përfituar tri pagesa si dëmshpërblim për ish të dënuar/persekutuar politikë, në shumën totale prej 1,099,333 lekësh⁴².
104. Në përfundim të sa më sipër, Komisioni ka kryer përlogaritjet, me aq sa mund të administrohej, për të ardhurat e dokumentuara të babait të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë rezultuar në masën 6,923,439 lekë. Pas përlogaritjeve dhe të shpenzimeve të jetesës për dy persona⁴³, ka rezultuar se babai i subjektit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 6,289,057 lekë, siç është detajuar në tabelën në vijim:

Tabela nr. 8 – Të ardhurat dhe shpenzimet e prindërve të subjektit

³⁵ Vërtetim nr. *** prot., datë 20.5.2014, nga ISSH-ja për znj. D. K., e cila ka përfituar pension pleqërie nga 10.1.1981 – 9.12.2012; vërtetim nr. *** prot., datë 20.5.2014, nga ISSH-ja për z. H. K., i cili ka përfituar pension pleqërie nga 10.3.1988 – 27.5.2014.

³⁶ Shkresat nr. *** prot., datë 11.7.2017 dhe nr. *** prot., datë 5.2.2020, të ardhura nga ISSH-ja.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2020.

³⁸ Të Komisionit, të ISSH-së dhe të Komisionit sërish me nr. *** prot., datë 29.1.2021.

³⁹ Duke përfshirë këtu edhe shtesat për energji elektrike dhe kompensim për bukë.

⁴⁰ Duke përfshirë këtu edhe shtesat për energji elektrike dhe kompensim për bukë.

⁴¹ Shkresë nr. *** prot., datë 10.11.2020.

⁴² Në llogarinë e shtetasit H. K. në BKT kanë kaluar përkatësisht pagesat në shumën: 383,000 lekë, më 24.5.2011; 333,333 lekë, më 27.6.2012 dhe 383,000 lekë, më 27.7.2012.

⁴³ Shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999 janë përlogaritur në masën 66% të të ardhurave (duke përfshirë edhe vitet 1997 – 1999, pasi nëse do të përlogaritej shpenzimi në masën 5,000 lekë/muaj për person, atëherë shpenzimet do të rezultonin më të larta se të ardhurat e tyre nga pensionet). Nga viti 2000, shpenzimet janë konsideruar sipas standardit të përdorur nga ILDKPKI-ja, sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, për dy persona. Për vitin 2007, është përlogaritur njëmesata e vitit 2006 dhe vitit 2008, për shkak të dyfishimit të tyre në vitin 2007.

Të ardhura nga pensioni të babait	2 231 217
Të ardhura nga pensioni të nënës	2 332 889
Të ardhura nga EKB	1 260 000
Të ardhura nga dëmshpërblimet	1 099 333
Shpenzime jetese	(3 512 496)
Dhuruar djalit	(9 700 000)
Rezultati	(6 289 057)

105. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit lidhur me konstatimin se:

- *Duket se babai i subjektit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare në masën 6,289,057 lekë, për të mundësuar dhurimin e shumës prej 9,300,000 lekësh, në favor të subjektit të rivlerësimit.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

106. Subjekti ka shpjeguar se babai i tij i ka përfituar të ardhurat që i kanë mundësuar kursimin e shumave të dhuruara atij edhe nga dhënia me qira e tokës që zotëronte *de facto*, e cila më pas me vendimin e organeve përkatëse, u është njohur edhe *de jure* dhe kthyer. Sipas tij, të ardhurat e përfituara nga qiradhënia provohen me vendimin e prokurorisë së vitit 2015. Ndonëse detyrimin për pagimin e detyrimeve tatimore e ka pasur babai, kjo nuk do të thotë se ai nuk ka pasur të ardhura të ligjshme. Gjithashtu, edhe përgjatë seancës dëgjimore, subjekti është shprehur se nuk ka dijeni nëse babai i tij i ka paguar apo jo detyrimet tatimore lidhur me përfitimet financiare të realizuara nga qiradhënia e pretenduar.

Vlerësimi i trupit gjykues

107. Trupi gjykues vlerëson se rezultati dhe konkluzioni i Komisionit i njoftuar me rezultatet e hetimit nuk mund të ndryshojë në këtë fazë, për sa kohë nga shpjegimet e paraqitura nga subjekti, veç pohimeve apo pretendimeve që mbetën në nivel deklarativ, nuk rezulton që të jetë provuar me dokumentacion ligjor burimi i ligjshëm i babait të tij, për të gjithë dhurimin në analizë. Konkretisht, përfitimi i të ardhurave nga qiradhënia e tokave, që as nuk legjitimohej zotërimi i tyre – sikurse është pohuar nga subjekti – nuk lë hapësirë për cilësimin e shumave të pretenduara si të përfituara, si të ligjshme. Gjithashtu, nuk është provuar asnjë marrëdhënie kontraktore përgjatë periudhës së referuar, që të mund të mbështeste burimin formal të përfitimeve, sikurse nuk është provuar – madje as nuk është pretenduar – pagimi i detyrimeve tatimore për këto të ardhura. Për më tepër, të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia janë përfituar në një kohë më të hershme se kthimi pas i tokës babait të subjektit, nga organet përkatëse dhe, për rrjedhojë, nuk ka qenë pronar i ligjshëm i pasurisë së dhënë me qira.

108. Për sa më lart, trupi gjykues çmon se babai i subjektit ka pasur një mungesë të burimeve të ligjshme financiare, së paku në masën 6,289,057 lekë, për të mundësuar dhurimin e shumës prej 9,300,000 lekësh, në favor të subjektit të rivlerësimit

6. Lidhur me shpenzimet për shkollimin e fëmijëve të subjektit

109. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shpenzimet e arsimit të fëmijëve të tij nga viti 2012 e në vijim, përkatësisht: në shumën 4,713 euro në 2012; në shumën 4,600 euro në 2013; në shumën 6,600 euro në 2014; në shumën 19,250 euro në 2015; si dhe në shumën 25,000 euro në vitin 2016, fillimisht pranë institutit arsimor “***” dhe më pas studimet e larta në Francë dhe në Itali.
110. Pas kërkesës së dërguar nga Komisioni⁴⁴, me shkresën nr. *** prot., datë 24.11.2020, instituti arsimor “***”, ka paraqitur pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit për fëmijët D. dhe U. K., nga viti 2012 e në vijim.
111. Nëpërmjet pyetësorit nr. 4, Komisioni i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të bëjë me dije mbi arsimin e ndjekur nga fëmijët jashtë Shqipërisë, duke bashkëngjitur edhe dokumentacionin që të provojë shpenzimet e kryera për secilin prej tyre. Në përgjigje të sa më sipër, subjekti është shprehur se shpenzimet janë pasqyruar në deklaratimet e tij periodike dhe dokumentacionin provues e ka paraqitur në pyetësorët e mëparshëm. Po ashtu, ka bërë me dije se djali i tij ka ndjekur studimet në U. A. të P. në vitin shkollor 2015 – 2016 dhe, më pas, në kuadër të këtyre studimeve ka kryer një vit shkollor, përkatësisht 2016 – 2017 në Universitetin B., Milano. Vajza ka filluar shkollimin në Universitetin Shtetëror të Parisit në vitin shkollor 2018 – 2019.
112. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1, lëvizjet bankare të llogarisë së bashkëshortes në “ABI Bank”, nga Komisioni janë evidentuar vetëm transfertat e shumave përkatësisht: në shumën 4,449 euro në vitin 2015; dhe në shumën 19,454 euro në vitin 2016.
113. Po ashtu, nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni, janë evidentuar transfertat e parave të kryera nga bashkëshortja e subjektit nga llogaria e saj në “Intesa Sanpaolo Bank” dhe nëpërmjet “AK-Invest”, përkatësisht: në shumën 1,800 euro në vitin 2015; dhe në shumën 4,400 euro në vitin 2016⁴⁵.
114. Nga shqyrtimi i lëvizjeve bankare është konstatuar se transfertat e kryera nëpërmjet “ABI Bank”, për vitet 2015 dhe 2016, janë me përfitues shkollat për studimet dhe strehimin, por nuk është provuar me dokumentacion nga subjekti shuma e shpenzimeve totale.
115. Për pasojë, Komisioni ka kryer kërkimet në faqet zyrtare të universiteteve⁴⁶ në fjalë, nga ku ka rezultuar se:
- a. tarifatat e shkollimit për vitin shkollor 2015 – 2016, në Universitetin Amerikan të Parisit kanë qenë përkatësisht në shumën 15,944 euro dhe 15,520 euro;

⁴⁴ Kërkesë nr. *** prot., datë 10.11.2020, për institutin “***” dhe kërkesë nr. *** prot., datë 10.11.2020 për shkollën fillore jopublike *** të deklaruar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1. Shkolla “***” ka bërë me dije me anë të shkresës nr. *** prot., mbi tarifatat vjetore të paguara nga subjekti për të dy fëmijët, gjatë periudhës 2003 – 2011.

⁴⁵ Ndër të tjera, nga Unioni Financiar Tiranë jemi informuar mbi 5 transfertat kryera nga bashkëshortja e subjektit, nëpërmjet Western Union, gjatë periudhës 2015 – 2020, në shumën totale 3,479 euro, për të cilat nuk është evidentuar datat e sakta dhe përfituesit.

⁴⁶ Faqet zyrtare të universiteteve përkatëse të ndjekura nga djali i subjektit në Francë <https://www.aup.edu/admissions/undergraduate/tuition-costs>; <https://www.aup.edu/admissions/summer/tuition-costs>; dhe në Itali <https://www.unibocconi.eu/wps/wcm/connect/b0b9894f-efa5-4c60-a8d7-e4171aafa485/16-shkollor2020-2021-dhe-Komisioni-ka-për-llogaritur-këto-shpenzime-të-indeksuara-me-nomat-e-inflacionit-në-Francë-deri-në-vitin-2015.17%2B1st+year.pdf?MOD=AJPERES>. Për U. A. të P., në faqen e web-it janë të dhënat për vitin

- b. shpenzimet e jetesës në Paris për vitin shkollor 2015 – 2016 kanë qenë përkatësisht në shumën 7,054 euro dhe 6,236 euro⁴⁷;
- c. shkolla verore⁴⁸ në Paris për vitin 2016 ka qenë në shumën 3,928 euro;
- d. shpenzimet e jetesës në Paris gjatë ndjekjes së shkollës verore për vitin 2016 kanë qenë në shumën 4,677 euro⁴⁹;
- e. tarifa e shkollimit për vitin 2016 – 2017 (kësti i parë i vitit 2016), në Universitetin B. në Milano ka qenë në shumën 2,331 euro⁵⁰;
- f. shpenzimet e jetesës për një periudhë 3-mujore në 2016, në Milano, ka qenë në shumën 3,000 euro⁵¹.

116. Nga sa më sipër, ka rezultuar se shpenzimet totale për vitet 2015 dhe 2016, për shkollimin e djalit në Universitetin A. të P. dhe në Universitetin B. të Milanos dhe shpenzimet e jetesës, kanë qenë përkatësisht një shumat rreth 22,998 euro dhe 35,692 euro⁵².

117. Nga analiza financiare e viteve 2015 dhe 2016, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare, për të përballuar shpenzimet e kryera për shkollimin dhe shpenzimet e tjera gjatë këtyre viteve.

118. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, lidhur me konstatimin se:

- *Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur mjaftueshmëri të burimeve të ligjshme financiare për përballimin e shpenzimeve të shkollimit të djalit në Francë dhe në Itali, si dhe shpenzimeve të tjera të kryera në vitet 2015 dhe 2016, mangësitë e të cilave përshkruhen në tabelën financiare të viteve përkatëse, në paragrafin vijues të analizës financiare të përgjithshme.*

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

119. Subjekti ka shpjeguar se ka deklaruar rregullisht shpenzimet e kryera për arsimin e fëmijëve dhe se djali i tij ka përfituar bursë në vitet 2015 dhe 2016 dhe, gjithashtu, ka paraqitur në cilësinë e provës për të ardhura shtesë të përfituara dhe, konkretisht, njoftimet e marra për përfitimin e bursave të studimit në vitet 2015 dhe 2016, përkatësisht në shumat 11,000 euro dhe 11,460 euro.

Vlerësimi i trupit gjykues

120. Komisioni, lidhur me këto prova të paraqitura përgjatë seancës së datës 7.6.2021, nuk i konsideron në formën dhe përmbajtjen e duhur për t'i vlerësuar me vlerë të plotë provuese, për sa kohë ato nuk vërtetojnë kalimin/përfitimin konkret të shumave të referuara si bursa studimi. Megjithatë, duke konsideruar rrethanat specifike dhe impaktin e tyre, konstaton

⁴⁷ Për shpenzimet e jetesës në Paris, Komisioni ka konsideruar variantin më të ulët të shpenzimeve "Low end budget", bazuar në faqen zyrtare të Universitetit A. të P..

⁴⁸ Nga transfertat bankare është konstatuar se bashkëshortja e subjektit ka paguar edhe shkollën verore për djalin në Universitetin A. të P..

⁴⁹ Këto shpenzime janë llogaritur në mënyre përpjestimore, për një periudhë 3-mujore, në bazë të shpenzimeve të jetesës gjatë periudhës së vitit shkollor 2015 – 2016, e cila sipas shkollës përfshin 5 muaj në sezonin e vjeshtës dhe 4 muaj në sezonin e pranverës.

⁵⁰ Kjo tarifë përbën vetëm këstin e parë të pagueshëm deri në dhjetor 2016. Komisioni ka marrë në konsideratë kategorinë e parë, për familje me të ardhura të ulëta (0-54,000 euro në vit).

⁵¹ https://www.unibocconi.eu/wps/wcm/connect/Bocconi/SitoPubblico_EN/Navigation+Tree/Home/about+us/history+and+identity/About+Milan/Living+and+Working/. Shpenzimet mujore për studentët variojnë nga 1,000 – 1,500 euro në muaj dhe Komisioni ka konsideruar shpenzimet minimale prej 1,000 euro/muaj.

⁵² Ndërkohë, nga subjekti këto shpenzime janë deklaruar përkatësisht: në shumat 14,500 euro për vitin 2015 dhe 22,000 euro për vitin 2016.

se edhe duke i përfshirë ato si të ardhura në analizën financiare, pra, duke pakësuar shpenzimet e përballuara nga subjekti për arsimimin e fëmijëve, rezultati do të përmirësohet me vlerën prej 3,064,344 lekësh, por pamundësia për t'i përballuar të gjitha shpenzimet e arsimimit në fjalë, vijon të mbetet e konsiderueshme.

7. Rezultatet e analizës financiare

121. Në vijim të analizës financiare të kryer mbi deklaratimet periodike, ndër vite, pas përlogaritjeve të kryera në mënyrë të detajuar sipas viteve, në aneksin nr. 1 që i bashkëngjitet këtij dokumenti, janë paraqitur të gjitha të dhënat mbi të ardhurat, shpenzimet, kursimet dhe detyrimet dhe nga përlogaritja krahasimore e tyre mund të vlerësohet dhe konkludohet mbi mjaftueshmërinë e burimeve financiare, për çdo vit, për të përballuar investimet, shpenzimet apo kursimet e deklaruara dhe/ose të konstatuara, me të ardhura nga burime të ligjshme, në kuptimin e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

122. Në këtë analizë janë paraqitur:

- i. Të gjitha pasuritë të luajtshme dhe të paluajtshme të realizuara nga subjekti i rivlerësimit dhe anëtarët e familjes, të pasqyruar në vitin përkatës të kryerjes së investimit, me vlerën e përcaktuar në dokumentacionin përkatës të kontratave të shitblerjeve/porosive dhe deklarimeve të subjektit të rivlerësimit. Për pasuritë e luajtshme janë shtuar edhe shpenzimet e zhdoganimit referuar aktzhdoganimeve.
- ii. Të gjitha të ardhurat e deklaruara, ndër vite, si dhe të ardhurat e dokumentuara, bazuar në përgjigjet e institucioneve dhe dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit bashkëngjitur deklaratës *Vetting* dhe në përgjigje të pyetësorëve.
- iii. Të ardhurat e deklaruara nga subjekti nga qiradhënia, të ardhurat nga aksionet në shoqëritë “***” sh.a. dhe “***” sh.a. dhe të ardhurat nga tokat, nuk janë përfshirë në analizën financiare, si të ardhura me burim të ligjshëm.
- iv. Shpenzimet jetike janë përlogaritur në bazë të frymëve sipas të dhënave zyrtare nga INSTAT. Për vitin 2007, është përlogaritur një mesatare e vitit 2006 dhe vitit 2008, për shkak të dyfishimit të tyre në vitin 2007. Deri në vitin 1997, shpenzimet jetike janë përlogaritur në masën 66% të të ardhurave, ndërsa për periudhën 1997–1999, janë përlogaritur në masën 5,000 lekë/muaj për person.
- v. Shpenzimet e arredimit/mobilimit janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në DIPP-të përkatëse.
- vi. Shpenzimet e shkollimit të fëmijëve janë konsideruar sipas detajimit në pikën 13 të këtij relacioni.
- vii. Në shpenzimet e udhëtimit janë përfshirë, në këtë fazë, vetëm ato të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në DIPP-të ndër vite.
- viii. Shpenzimet e interesave dhe komisioneve të kredive/kartave të kreditit janë marrë nga lëvizjet bankare të llogarive të ardhura nga bankat e nivelit të dytë.
- ix. Gjendja e likuiditeteve nënkupton gjendjen në fund të çdo viti të ndodhur në të gjitha llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe anëtarëve të familjes, si dhe gjendjes së disponuar *cash* në banesë.

- x. Kursi i këmbimit i përdorur për të gjitha investimet/shpenzimet/gjendjet bankare në valutë është konsideruar sipas kursit mesatar të fundit të vitit, botuar në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë.
- xi. Detyrimet përfshijnë gjendjen në fund të çdo viti të të gjitha detyrimeve të dokumentuara dhe të provuara të subjektit të rivlerësimit ndaj bankave të nivelit të dytë dhe huadhënësve. Në këtë seksion janë shënuar dhe likuidimet e kryera në vijim, të këtyre detyrimeve, me vlerë negative.

123. Në këtë analizë janë konsideruar dhe përpunuar të dhënat duke filluar nga viti 2003, vit në të cilin fillon edhe deklarimi i pasurisë nga subjekti në ILDKPKI, nga ku, për aq sa është administruar nga Komisioni deri tani, ka rezultuar një bilanc i përgjithshëm negativ në vlerën 37,554,251 lekë, siç është detajuar më poshtë.

Aneksi nr. 1 – Analiza financiare për periudhën 2003 – 2016

Viti	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
PASURI	0	1,950,000	5,313	6,981,993	-164,328	-13,553	10,386	-17,392	8,163,466	6,528	67,956	2,373,877	1,199,811	-795,259
Toke bujqesore Gramsh 4,000 m2 (perf me 7501 - nena)														
Automjet vit prodhimi 1999														
Aksione ne R*** Sh.a. (letra me vlere te trasheguara)														
Aksione R*** E*** Sh.a. (letra me vlere trasheguara) 2%														
Apartament 2+1 ne L. K. E. (b/sh)		1,950,000												
Shetpi private (truall 255m2 dhe ndertese 89m2), Elbasan				6,800,000										
10 Ha ullij ne Komunen F., Elbasan														
Apartament duplex ne Tirane								8,159,700				1,453,081		
Toke bujqesore Gramsh 7,400 m2 (perf me 7501 - babai)														
Toke are 2,012 m2 ne L., Fier (b/sh)														
Ndryshim likuiditeti	0	0	5,313	181,993	-164,328	-13,553	10,386	-17,392	3,766	6,528	67,956	920,797	1,199,811	-795,259
TOTAL LIKUIDITETE DEKLARUAR	0	0	5,313	187,307	22,979	9,426	19,812	2,420	6,185	12,714	80,670	1,001,467	2,201,278	1,406,019
DETYRIME	0	0	0	0	-683,532	-1,166,059	-678,657	-698,075	-1,221,637	-245,579	-270,394	-2,300,782	-324,441	-340,533
Huamarrje nga A. A.					-1,000,000	-500,000								
Huamarrje nga S. M.						-500,000		-500,000	-1,000,000					
Huamarrje nga A. Xh.					-500,000		-500,000							
Huamarrje nga P. Xh.					-1,000,000									
Huamarrje nga A. K.					-604,550									
Kredi ne RZB dt 15.06.2007 (2.500.000 Leke)					2,421,018	-166,059	-178,657	-198,075	-221,637	-245,579	-270,394	-300,782	-324,441	-340,533
Dhene hua shtetasit S. J.												-2,000,000		
PASURI NETO	0	1,950,000	5,313	6,981,993	519,204	1,152,506	689,043	680,683	9,385,102	252,108	338,350	4,674,660	1,524,252	-454,726
Te ARDHURA dokumentuar	602,969	914,460	883,873	980,570	954,309	951,107	1,027,830	1,178,316	1,580,940	1,532,650	7,139,904	2,534,370	1,752,684	1,677,333
Te ardhura SR vertetur	602,969	878,720	870,013	902,556	893,551	860,337	1,027,830	1,005,959	1,023,150	1,068,108	1,139,904	1,343,430	1,399,800	1,357,653
Te ardhura BSH vertetur	-	35,740	13,860	78,014	60,758	90,770	-	172,357	557,790	464,542	6,000,000	1,190,940	352,884	319,680
Dhurate nga babai*										3,410,943				
SHPENZIME	390,456	390,456	458,228	478,228	707,349	820,448	834,427	836,994	826,212	1,315,809	1,610,116	6,596,546	5,980,109	6,497,416
Shpenzime jetese	375,456	375,456	438,228	438,228	492,354	546,480	546,480	546,480	546,480	564,096	564,096	879,992	897,104	940,368
Shpenzime arsimit per femijet	15,000	15,000	20,000	40,000	50,000	60,000	80,000	85,000	100,000	600,796	925,386	763,600	4,108,519	5,370,431
Shpenzime per mobilim												2,000,000		
Shpenzime per ullishten												2,500,000		
Shpenzime udhetimi												350,275	344,125	
Shpenzime gjobe per ILDKPKI													400,000	
Shpenzime per pagese karte krediti L. K.													189,269	167,735
Shpenzime per regjistrimin e apartamenteve													25,961	
Shpenzime interesi/ komisione/ sigurime te kredise RZB					164,995	213,968	207,947	205,514	179,732	150,917	120,634	76,719	41,092	18,883
Analiza dokumentuar	212,513	-1,425,996	420,332	-6,479,651	-272,244	-1,021,847	-495,640	-339,361	-8,630,375	-35,267	5,191,438	-8,736,836	-5,751,677	-4,365,357
CASH në lekë												1,000,000	1,000,000	1,000,000
DIFERENCA E PA MBULUAR		-37,554,251												

* Duke qenë se kjo shumë është dhënë pas bashkimit, në datë 09.12.2012, kjo shumë nuk mund të ishte përdorur prej subjektit për mbulimin e investimeve/shpenzimeve të vitit dhe për rrjedhojë nuk impaktan analizën financiare të vitit.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

124. Subjekti i rivlerësimit, pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ mbi kriterin e pasurisë në lidhje me problematikat e konstatuara më sipër, ka paraqitur në seancë shpjegimet e tij, si dhe dokumentacion mbështetës, të cilat janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga trupi gjyqës në mënyrën e shprehur më sipër, përgjatë arsyetimeve të kryera për secilin pretendim që lidhet me burimet financiare dhe me pasuritë e analizuar.

125. Lidhur me analizën financiare, subjekti ka pretenduar se përfshirja në analizë e të ardhurave të tij nga aksionet dhe shpërndarja e dividendëve, nga qiradhënia, të ardhurat nga shitja e prodhimeve të tokës, nga huat e marra në vitin 2006, mbartja e shumave në

gjendjen *cash* e të ardhurave të dhuruara nga babai dhe nga shitja e tokës së bashkëshortes së subjektit, do të reduktonte ndjeshëm balancën negative.

Vlerësimi i trupit gjykues

126. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit – përpos shpjegimeve jo bindëse dhe pretendimeve që mbeten në nivel deklarativ, ndonëse ka tentuar të paraqesë disa prova indirekte – ka dështuar të provojë me dokumente ligjor dhe me vlerë të plotë provuese, brime të ligjshme alternative dhe shtesë, përtej atyre të konsideruara si të tillë nga Komisioni. Për rrjedhojë, konfirmohen rezultatet e arritura nga Komisioni.
127. Gjithashtu, vlen të theksohet se edhe nëse do të pranoheshin pretendimet e subjektit dhe do të përfshiheshin në analizë financiare shumat e përfituara nga djali i tij në formën e bursave të studimit dhe, veç tyre, të mos konsideroheshin si shpenzime të subjektit as shumat e deklaruara prej tij si pagesa, ndër vite, për kthimin pas të huave (sipas tij meqenëse ato nuk janë konsideruar nga Komisioni si burime të ligjshme), rezultati i përgjithshëm i analizës financiare do të ndryshonte nga -37,554,251 lekë në -31,382,662 lekë, duke mos ndryshuar kësisoj as konkluzioni final lidhur me kriterin e pasurisë dhe as pasjellja e pasojave përkatëse të këtij konkluzioni mbi rivlerësimin e subjektit.
128. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni vlerëson se për sa i takon kriterit të pasurisë, bazuar në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, subjekti i rivlerësimit, z. Tomorr Kullolli, nuk ka pasur burime financiare të mjaftueshme, sipas përcaktimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, për të kryer të gjitha investimet e konstatuara dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Nisur nga ky rezultat financiar, trupi gjykues nuk e konsideron të nevojshme analizimin e pikave të tjera të rezultateve të hetimit⁵³, pasi referuar problematikave që kanë rezultuar lidhur me deklaratimet e pasurive të sipërtrajtuara, mjaftojnë për aplikimin e masës disiplinore.

Në konkluzion, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

- **Lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme – sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës – për të kryer të gjitha investimet dhe, njëkohësisht, për të përballuar shpenzimet apo për të realizuar kursimet e deklaruara. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklaratimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5 e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe pika 3 e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.**

Në këto kushte, trupi gjykues bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin se subjektit të rivlerësimit, z. Tomorr Kullolli, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, duhet t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

⁵³ Lidhur me automjetin, tokat dhe konfliktin e interesit.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, në nenin D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Tomorr Kullolli, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 9.6.2021.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Valbona Sanxhaktari
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Xhensila Pine
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi